




DALLIME IDENTIKE

Ese mbi përkthimin

Driton Kajtazi

ISEAL

Driton Kajtazi

DALLIME IDENTIKE

Ese mbi përkthimin

ISEAL

2017

ISEAL

Institut Suisse d'Études albanaises
Istituto Svizzero per gli Studi albanesi
Instituti Zviceran i studimeve shqiptare
Schweizerisches Institut für albanische Studien

Sektori i botimeve **ISEAL**

Përkthimi nga frengjishtja: Belgzim Kamberi

Korrigjimet: Sulejman Dërmaku

Faqosja: Labinot Hasani

Titulli në origjinal: *DIFFÉRENCES IDENTIQUES*, Essai sur la traduction,

Editions ISEAL, 2016

Foto e ballinës: © **BETOGJENI**

ME MBËSHTETJEN E



DALLIME IDENTIKE

FALËNDERIME

Prof. dr. Edo Poglia (Universiteti i Luganos), mentor i punimit të magjistraturës pranë MIC (Master of Advanced Studies in Intercultural Communication), që e mundësoi botimin e këtij libri; për këshillat e tij, mësimin e tij dhe sugjerimet e tij;

Prof. dr. Doris Jakubec (Universiteti i Lozanës), për mbështetjen e saj të çmueshme, jo vetëm për këtë libër, por edhe për antologjinë e letërsisë së Zvicrës franceze HËNORE E ZVICRËS dhe punimet e tjera të shkruara;

Prof. dr. Basil Schader (HEP Cyrih), për mbështetjen e tij dhe për vështrimin e tij kritik, aq të çmueshëm për një përfytyrim më të mirë;

Prof. dr. Nerimane Kamberi dhe Arbesë Hoxha për leximet, sugjerimet dhe vështrimet e tyre kritike;

Të gjithë personat të cilët me pasion dhe motivim kanë pranuar të kontribuojnë në hulumtimin kualitativ të zhvilluar në Prishtinë.

Hyrje: Përkthimi është kulturë	9
---	----------

KAPITULLI 1

Përkthimi: përpjekje e përkufizimit	15
1.1 Fjala «përkthim».....	17
1.2 Natyra e «përkthimit».....	19
1.3 «Llojet» e ndryshme të përkthimit (me shkrim dhe me gojë).....	22
1.3.1 Përkthimi i teatrit.....	23
1.3.2 Përkthimi i «eseve».....	24
1.3.3 Përkthimi dhe «poezia».....	24
1.3.4 Përkthimi dhe «proza».....	25
1.3.5 Përkthimi i «lojës së fjalëve».....	26
1.3.6 Përkthimi i «librave shkencorë».....	27
1.3.7 Përkthimi i librave «fetarë».....	27
1.3.8 Përkthimi i «broshurave turistike».....	28
1.3.9 Përkthimi me gojë dhe interpretimi.....	29
1.3.10 Përkthimi i filmave.....	30
1.3.11 Përkthimi i teksteve zyrtare	31
1.3.12 Përkthimi i njoftimeve të paketimeve	31
1.3.13 Përkthimi i dokumenteve zyrtare, reklamave, internetit.....	32
1.3.14 Përkthimi «automatik».....	32

KAPITULLI 2

<i>Në vend të “shokut kulturor”, “shok i kultivuar”</i>	35
---	-----------

KAPITULLI 3

<i>Aspektet shoqërore, materiale dhe institucionale të përkthimit.....</i>	39
3.1 Statusi i përkthyesve	41
3.2 Shoqatat e përkthyesve	42
3.3 Aftësimi i përkthyesve.....	44
3.4 Roli i përkthimit në komunikim në shkallë ndërkombëtare	46
3.5 Roli i përkthimit në komunikim në Evropë.....	48
3.6 Roli i përkthimit në komunikim në Zvicër.....	50

KAPITULLI 4

<i>Përkthimi në ndërtimin e Kosovës së «re»</i>	53
4.1 Disa përkujtues lidhur me gjuhën shqipe	55
4.2 Komunikimi në Kosovë dhe përkthimet.....	58
4.3 Përkthimi, një sfidë për administratën e re.....	59

4.4	Komunikimi në kushtet e «izolimit»	60
4.5	Sfidat e reja të përkthimit në Kosovë	63

KAPITULLI 5

<i>Përfundim: Prolog në vend të epilogut</i>	67
--	----

Shtojcat: Hulumtim kualitativ në Kosovë mbi temën e «përkthimit dhe komunikimit»	73
Refleksione dhe hipotezat.....	75
Metodologjia.....	78
Rezultatet e intervistave	82
Përfundime.....	91
Bibliografia	93

PËRKTHIMI ËSHTË KULTURË

*«Përkthyesit jetojnë nga dallimi i gjuhëve,
por punojnë për ta zvogëluar atë».
Edmond Cary*

Përkthimi është një nga shtyllat kryesore të komunikimit, të ndërtimit, të kuptimit dhe të kohezionit të Evropës, por edhe midis të gjitha shoqërive dhe të gjithë individëve. Përkthimi është gjuha e qenieve njerëzore, përveç gjuhës që kanë mësuar më së pari. «Gjuha e evropianëve është përkthimi», pëlqen të thotë Umberto Eco.

Evropa nuk thjeshtohet në shkëmbimet tregtare dhe politike. Ajo synon edhe një dimension njerëzor dhe kulturor, që ia jep një shpirt, për ta bërë të jetojë në të gjitha dimensionet e saj, përfshirë edhe në shkëmbimet tregtare dhe politike.

Në kohën kur Evropa po zgjerohet me anëtarë të rinj dhe me një shumësi gjuhësh, shtetet e reja dhe gjuhët e reja po përfshihen në mozaikun e saj gjuhësor. Kombe dhe gjuhë të tjera, si: shqipja, boshnjakishtja, kroatishtja, malazezishtja, maqedonishtja, serbishtja, ose edhe turqishtja e kurdishtja, po trokasin dhe po presin në dyert e Evropës. Ndërkohë, një shtet po e braktis Evropën...

«Përkthimi i përgjigjet një nevojë thellësisht njerëzore: të komunikosh me njerëzit në të gjitha rrethanat, përtej pengesave që përfaqësojnë gjuhët, me gjithë përafrimet, dështimet dhe rreziqet e tradhtisë që ua veshin me aq lehtësi përkthyesve», pohon Jean-Claude Gémard.⁽¹⁾

Pa i përmbysur të gjitha, por duke shtruar pyetje, duke folur, duke menduar dhe duke shkruar mbi përkthimin, nuk mund të mos ia shtrojmë vetes disa pyetje, si në vijim:

- Ç'do të ishin, pa përkthimin, diplomacia botërore dhe organizatat ndërkombëtare e kombëtare?

- Ç'do të ishin, pa përkthimin, hulumtimet shkencore dhe sidomos qasja në zbulime?

- Ç'do të ishte, pa përkthimin, fati i Biblës, Kuranit, Toras ose edhe i Hari Poterit apo Tarzanit?

- Ç'do të ishte, pa përkthimin, aviacioni civil ose ushtarak?

- Ç'do të ishin tregjet dhe shpërndarja e produkteve të ndërmarrjeve të mëdha dhe të vogla shumëkombëshe, ose njëkombëshe në vendet shumëgjuhësore, siç janë Zvicra dhe Belgjika, pa përkthimin?

- Ç'do të ishte, pa përkthimin, fati i Lojërave Olimpikë, i Botërorit të futbollit ose i ngjarjeve të tjera sportive?

1. Jean-Claude Gémard, Traduire, ou l'art d'interpréter, Québec, Presse Universitaire de Québec, 1995, en couverture.

- Ç' do të ishte, pa përkthimin, dashuria për gjuhët dhe dashuria midis dy njerëzve, të cilët duhen dhe që nuk e flasin gjuhën e njëjtë?

Lista është vërtet e gjatë dhe ky libër e thekson, ose e rithekson, rolin qendror, që luan përkthimi në të gjitha komunikimet ndërkulturore, sikurse midis folësve të gjuhëve dhe të kulturave, ashtu edhe brenda gjuhës së njëjtë.

Por, qëllimi i këtij teksti është edhe të rikujtojë se përkthimi, ose përdorimi i përkthimit, mund të luajë një rol negativ në komunikimin midis individëve, grupeve dhe shoqërive, të cilat nuk shprehen as në mënyrën e njëjtë dhe as në gjuhën e njëjtë.

Shprehja «fshati global» (*global village*), e përdorur për herë të parë nga Marshall McLuhan më 1964 në *Pour comprendre les médias (Për t'i kuptuar mediet)*⁽¹⁾, mund të jetojë tani e tutje falë përkthimeve. Po, përkthimet janë si dritaret e këtij «fshati global». Këto shtëpi komunikojnë me botën falë tyre. Edhe pse këto dritare janë një lloj pengese, drita, megjithatë, arrin t'i ndriçojë shtëpitë, t'ua japë dritën e nevojshme, pamjen e domosdoshme.

Një studim nga Gisèle Sapiro, kushtuar tregut të përkthimit në kohën e globalizmit, tregon se numri i përkthimeve ishte rritur për 50% në botë, në mes të viteve 1980 dhe 2000. Ndërkohë, Franca ishte bërë shteti i parë i përkthimit, me 13% të përkthimeve të realizuara në botë më 2004.»⁽²⁾ Por, pabarazitë janë larg së pakësuar, lidhur me mundësitë dhe me mjetet socio-ekonomike, si dhe me qasjen në përkthime. «Fjalimi entuziast i ish-presidentit libanez Camille Chamoun, para Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 1964, në dobi të përkthimit të veprave të mëdha të kulturës universale në gjuhët e popujve më pak të përkrahura, paralajmëronte një nga problemet e mëdha kulturore të kohës sonë dhe përvijonte një rrugë të re»⁽³⁾. Ky fjalim rikujton një të kaluar të afërt, që pa dyshim ka lëvizur shumë nga vendi, porse mbetet ende një rrugë e tërë përpara.

Të mos harrojmë se «çdo përkthim hyn në ballafaqimin e gjuhëve. Nuk do të ketë, pra, teori të përgjithshme të përkthimit, e cila duhet t'i marrë parasysh të gjitha gjuhët dhe të mos shkruhet në ndonjërin prej tyre në mënyrë të veçantë»⁽⁴⁾ dhe po në këtë frymë, «një bindje atëherë imponohet: pasi që, në kuadër të gjuhëve tona, e jo vetëm të kufijtë të tyre, tashmë vepron përkthimi – kjo mikpritje gjuhësore – është alternativa jonë e vetme ndaj barbarisë»⁽⁵⁾.

1. Michaël Oustinoff, *La Traduction*, Paris, PUF - Que sais-je?, 2003, p. 110.

2. François Ost, *Traduire, Défense et illustration du multilinguisme*, Paris, Fayard, 2009, en postface.

3. Emile Delavenay, *La Machine à traduire*, Paris, PUF, Que sais-je, 1972, p. 9.

4. Philippe Forget, *Il faut bien traduire*, Paris, Masson, 1994, dans avant-propos.

5. François Ost, *Traduire, Défense et illustration du multilinguisme*, Paris, Fayard, 2009, en couverture.

Në kuadër të komunikimit ndërkulturor, të rikujtojmë se «përkthimi jep qasje, në planin etik, tek «vetja si tjetri», në vend të tjetrit si alter ego. Kësisoj, ai mbrohet nga shtjellat e tij asimiluese dhe hegjemoniste»⁽¹⁾.

Por, ky «vetja si tjetri» zbulon se, përveç «bukurisë dhe urtësisë», që gjenden tek njerëzit e të gjitha anëve, po ashtu aty gjenden edhe të metat.

Siç e thotë edhe proverbi shqiptar: «Nuk ka njeri pa gabime dhe nëse nuk e besoni, shikojeni vetveten».

Nuk ka as përkthim dhe as komunikim të përsosur, por përsosmërisht «përkthimi ka të bëjë me prodhimin, në gjuhën e caktuar, të barasvlerësit natyror, sa më të përafërt, të mesazhit të gjuhës përkatëse, së pari për sa i përket kuptimit, pastaj edhe stilit» ⁽²⁾.

Lidhur me pyetjen se a është përkthimi i nevojshëm apo jo për komunikimin, përgjigjja do të ishte: përkthimi është më shumë se i domosdoshëm për komunikimin.

Përkthimi për tekstet është ajo që fjalët janë për melodinë. Nëse melodia e shprehjes fizike flet në ritmin e njëjtë, mesazhi është i dërguar, jashtë çdo kufiri, duke ua siguruar një aspekt polifonik këmbimeve dhe komunikimeve, e kundërta e monotonisë së fjalëve monokorde.

E vlen këtu ta rimarrim një shprehje të dashur të komunikuesve: «nuk mund të mos përkthejmë»⁽³⁾.

Madje, në kohën e komunikimeve, këmbimeve, lëvizjeve, udhëtimeve të shkurtra e të gjata dhe takimeve të nxituara; habitemi që përkthimi ka ende kundërshtarë, të cilët ia refuzojnë atij rolin që luante dikur, ngase «funksioni i parë i përkthimit është praktik: pa të, komunikimi është i rrezikuar ose i pamundshëm. Interpretët në Egjipt kishin rangun e princit, për shkak të rëndësisë kryesore që mund të kishin në diplomaci»⁽⁴⁾.

Kapitujt në vijim paraqesin:

- Një përpjekje e përkufizimit të fjalës «përkthim».
- Një «gjendje» të përkthimeve ku do të shohim, në vija të trasha, «llojet» e ndryshme të përkthimit, aspektet socio-materiale dhe institucionale të përkthimit, aspektet organizative të përkthimit (të drejtat e autorit, çmimet, organizatat asociative), si dhe aspektet që kanë të bëjnë me aftësimin e përkthyesve.

1. Ibid., p. 12.

2. Georges Mounin, Les Problèmes théoriques de la traduction, Paris, Gallimard, 1963, en préface.

3. Mathieu Guidère, La Communication multilingue, Bruxelles, De Boeck Université, 2008, p. 5.

4. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, PUF, Que sais-je ?, 2003, p. 10.

- Përkthimet në nivel ndërkombëtar, evropian dhe zviceran.
- Përkthimi në ndërtimin e Kosovës së «re».
- Një hulumtim kualitativ mbi «komunikimin dhe përkthimin» në Kosovë dhe mbi një sintezë që e shoqëron atë.
- Një përfundim ose «një prolog në vend të epilogut», me disa sugjerime, që të vihet një gur në kalanë e komunikimit ndërkulturor, me përkthimet si prag të dyerve të saj.

Ky punim, që e trajton një temë aq të gjerë, siç është përkthimi dhe komunikimi, do të mjaftohet të skicojë disa qasje të ndryshme të përkthimit, siç janë:

- qasja deskriptive - «si përkthejmë?»
- qasja preskriptive - «si duhet të përkthejmë?»
- qasja teorike - «ç' duhet të përkthejmë?»

Dhe, për ta përfunduar këtë prolog, një paraqitje e gjendjes në Zvicër, me katër rajonet e saj gjuhësore; si dhe e gjendjes në Kosovë, gjithashtu shumëgjuhësore, të cilat janë shembuj, ku komunikimi ndërkulturor mbështetet gjerësisht mbi përkthimin.

Thelbi i hulumtimit tim është në Kosovë, sepse shqiptarët përbëjnë bashkësinë e dytë të huaj në Zvicër, pas italianëve, e që rreth 10% e popullatës së Kosovës jeton ose punon në Zvicër.

Një përkthim është, para së gjithash, një pasqyrim dhe një komunikim ndërkulturor. Duke u mbështetur mbi pasqyrime dhe jo mbi reflekse, ai do të rezultojë edhe më i pasur.

Zvicra është e pranishme në Kosovë me organizata të ndryshme, në mesin e të cilave do të përmend vetëm Agjencinë për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Terre des Hommes, Swisscoy, OSEO dhe Kryqin e Kuq.

Zvicra më 1991 ka kremtuar përvjetorin e 700-të të themelimit të saj, përderisa Kosova pavarësinë e saj e ka shpallur më 2008. Një kontrast i tillë, krahas pikëpamjes së përjetimit, meritonte të merrej parasysh dhe të thellohej në analizat komunikuese.

Kapitulli 1

PËRKTHIMI: PËRPJEKJE PËRKUFIZIMI

1.1 Fjala «përkthim»

«Të jesh i përkthyer, do të thotë pra ta zbulosh të panjohurën në vetvete»

Cécile Cloutier

E sikur ta përkthenim fjalën përkthim?

Shumë përkufizime kërkojnë t'i kristalizojnë, t'i shpjegojnë, t'i paraqesin ose edhe t'i bëjnë të kuptueshme këto dy folje: të përkthesh dhe të komunikosh.

«Të veprohet në atë mënyrë që ajo që është thënë në një gjuhë, të jetë e thënë në një gjuhë tjetër, duke synuar ekuivalencën e kuptimit dhe të vlerës së dy diskurseve», mund të lexojmë në «Le Robert Méthodique».

Fjala «komunikim», sipas po këtij fjalori, është njëkohësisht «të informojë», «të ndahet» ose edhe «të bëjë të përbashkët», «të përcjellë».

Etimologjia e traduction/përkthimit, në frëngjisht është të çosh «ducere», «të çosh në anën tjetër», «trans» ⁽¹⁾, por edhe nga latinishtja «tradere»: të lihet trashëgimi, të përcillet përmes traditës ⁽²⁾.

Në shqip, fjala përkthim thuhet «Përkthim». Dhe, të përkthesh fjalën përkthim në frëngjisht, fjalë për fjalë, rezulton «Për» dhe «kthim» - kthim. Për një kthim, drejt vetes, drejt tjetrit...

Përkufizimet e fjalës përkthim janë po aq të larmishme sa autorët që i kanë formuluar, por një pikë e përbashkët paraqitet në shumicën e këtyre përkufizimeve: komunikimi. Një prej përkufizimeve është ai i Mathieu Guidère, i cili thotë: «sot e tutje, përkthimi, është në një mënyrë të komunikosh në shumë gjuhë, të jesh përkthyes, pak është sikur të jesh komunikues shumëgjuhësor»⁽³⁾; e ai i Hatim dhe Mason në «The Translator as Communicator», për të cilin «përkthimi është i menduar si një akt komunikimi që përpiqet ta zëvendësojë një akt tjetër të komunikimit përtej pengesave gjuhësore dhe kulturore»⁽⁴⁾, ne pajtohemi të pohojmë se «të thuhet se përkthimi vepron mbi mesazhe, në fakt është të thuash me zë të lartë se ai është një akt komunikimi (ose një këmbim gjuhësor), para se të jetë një akt krahasimi ndërgjuhësor»⁽⁵⁾.

Të kujtojmë se përkthim është edhe interpretimi i kodoneve të ARN-s në aminoacide (kodi gjenetik). Pra, mendohet se «trashëgimi» e vërtetë e përkthimit është komunikimi.

Fjala përkthim në frëngjisht përdoret gjithashtu në shprehjen «traduire quelqu'un en justice» - ta padisë dikë.

1. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, PUF, Que sais-je ?, 2003, p. 50.

2. Jean-Luis Cordonnier, Traduction et culture, Namour, Hatier&Didier, 1995, p. 20.

3. Mathieu Guidère, La Communication multilingue, Bruxelles, De Boeck Université, 2008, p. 2.

4. Ibid., p. 12.

5. Maurice Pergnier, Les Fondements sociolinguistiques de la traduction, Lille, Uni Lille, 1978, p. 36.

Qëllimi i këtij libri nuk është aspak të polemizojë mbi përkthimin, duke kujtuar se është shtylla qendrore e komunikimit midis personave, shoqërive, kombeve dhe shteteve (që rrjedhin nga gjuhët dhe mjetet e ndryshme të shprehjes). Por, përkthyesi, apo përkthimi, ka qenë dhe vazhdon të jetë në bankën e të akuzuarve.

Para disa vjetësh (5 shkurt 2010), këshilltarja federale, Doris Leuthard, është ballafaquar me një problem përkthimi dhe «ka insistuar ta qartësojë gjendjen pas deklaratave të koleges së saj, Micheline Calmy-Rey. Sipas këshilltares nga Argovi, nuk ka përçarje brenda Këshillit Federal dhe nuk ka pasur prishje të kolegjalitetit. Ajo ka qenë e befasuar nga interpretimet e bëra në medie. Doris Leuthard ka përmendur një përkthim të keq në gjermanisht, të fjalëve të thëna në frëngjisht nga Micheline Calmy-Rey» (www.tsr.ch).

Disa muaj më vonë (RTK, 19:30, 9 qershor 2010), një nga dy zëvendëskryeministrat e Kosovës, publikisht dhe para të gjitha kamerave, ka kërkuar nga përkthyesi t'ia përkthejë përsëri fjalët e tij, sepse dukej se nuk ishte kuptuar nga bashkëbiseduesi. Si gjithnjë, gabimi kërkohet te përkthimi... Megan B., studente e Colette Laplace, tha një ditë: «Më sqaroni se çfarë mendoni dhe unë do të di ta shpjegoj»⁽¹⁾. Sepse, gjithherë lihet të nënkuptohet dhe të thuhet se «duhet kuptuar për të përkthyer». Edhe pse e përsërisim sa e sa herë këtë fjali, fundja është ndoshta një aksiomë, sigurisht se është e lehtë të dëshmohet e kundërta. Në fakt, të mos kuptosh asgjë, nuk të jep shumë mundësi!

Nëse do të duhej zgjedhur një fjalë e vetme për ta përmbledhur «përkthimin» dhe «komunikimin», ajo do të ishte fjala «kuptim».

Vërtet, «janë ngritur disa monumente për disa përkthyes, si për Shën Jeronimin (Uashington), Mesrop Machtots (Erevan), Judah Ibn Tibon (Granada), William Tyndale (Londër), Joost van den Vondel (Amsterdam), Jacques Amyot (Melun), Antoine Galland (Rollot) et Josef Jungmann (Pragë)»⁽²⁾, por sot, edhe po qe se i madhi Etienne Dolet nuk do të ishte ekzekutuar në një shesh publik, përkthyesi dhe përkthimi mbeten objekte mosbesimi, nganjëherë me të drejtë, por padrejtësisht si profesion dhe si përçapje të komunikimit. Përkthyesi, nga i cili gjithmonë drejtohet gishti, megjithatë mbetet aq i domosdoshëm për komunikimin.

1. Colette Laplace, *Théorie du langage et théorie de la traduction*, Paris, Didier Erudition, 1994, p. 10.
2. Delisle, *Les Traducteurs dans l'histoire*, Otaëa, Editions Unesco, 1995, p. 15.

1.2 Natyra e «përkthimit»

Ndonëse ka përmirësime në studimet e përkthimit, megjithatë nuk është shënuar ndonjë përparim madhor që disa shekuj.

Çuditërisht, studimet mbi përkthimin nuk kanë vazhduar, edhe pse përkthimi zë një vend moderues në komunikim tash disa dekada.

Sidoqoftë, «do të ishte e gabuar të mendohet se para mesit të shekullit XX, nuk është bërë asnjë vërtetim i dobishëm lidhur me teorinë e përkthimit. Dëshmi janë mendimet e Lutherit dhe ato të Dolet-it, në shekullin XVI, që janë nga më të përparuarat të periudhës moderne»⁽¹⁾. Etienne Dolet (1509-1546), për të cilin mund të thuhet se «është teoricienti ynë më i madh i përkthimit», në traktatin e tij të shquar: *Mënyrën për të përkthyer mirë nga një gjuhë në tjetrën*, vepër kjo që mbetet aktuale dhe mbase edhe një referencë, i ka parashtruar pesë parimet themelore.

Përkthimologjia, ose shkenca e përkthimit, nuk është vetëm një fushë veprimi e rezervuar për një disiplinë të vetme dhe as për një degë të vetme tematike. Përkthimi përpunon tekste dhe fjalë që prekin qenien e gjithsecilit, me tërë ndërlikimin që kjo kërkon. Lidhur me këtë, Jean Peeters shkruan:

«[...] shohim gjithashtu se përkthimologjia është një fushë e hapur ndaj qasjeve të tjera që vijnë nga fusha të tjera të hulumtimit (semiotika, linguistika kognitive, linguistika tekstuale, statistika, hermeneutika, psikologjia, sociologjia, bota e botimit etj.), thjesht sepse kemi vërejtur se fenomeni që e quajmë "përkthim" është shumë më kompleks sesa duket në shikim të parë [...]»⁽²⁾

Një sërë autorësh pajtohen për të thënë dhe për të shkruar, se përkthimi nuk e ka ende statusin e merituar në sektorët e bibliotekave shkencore, siç dëshmojnë konstatimet e ndryshme, si «bilanci është shumë zhgënjyes sa i përket teorisë së përkthimit, kemi përshtypjen se po sillemi kot pa i gjetur përgjigjet e kënaqshme për problemet e shtruara, apo më mirë të themi të prekur lehtëzi»⁽³⁾; ose «nëse fillojmë në Francë të vetëdijesohemi më shumë për rolin vendimtar të përkthimit për kulturat tona, pamjaftueshmëria e studimeve për këtë fenomen është e evidente»⁽⁴⁾; edhe «përkthimi është ndoshta një nga profesionet më të vjetra në botë. Por, sado e vjetër qoftë praktika, ajo nuk është analizuar në thellësi [...]»⁽⁵⁾.

1. Jean-Claude Margot, Traduire sans trahir, Lausanne, L'Age d'Homme, 1990, p. 15.

2. Jean Peeters, La Traduction, de la théorie à la pratique et retour, Rennes, PUR, 2005, introduction.

3. Jean-Claude Margot, Traduire sans trahir, Lausanne, L'Age d'Homme, 1990, p. 23.

4. Jean-Louis Cordonnier, Traduction et culture, Namour, Hatier&Didier, 1995, p. 18.

5. Actes du colloque international tenu à l'E.S.I.T., La liberté en traduction, Paris, Didier Érudition, 1991, en préface.

Shumë autorë pajtohen për të thënë dhe për të shkruar se përkthimi nuk e ka ende statusin e merituar në sektorët e bibliotekave shkencore. Mirëpo, as këta autorë, as vetë unë, nuk jemi ndalur që t'i sigurojmë mjetet e nevojshme për të shkuar deri në fund të hulumtimit tonë, që të shohim së paku gjendjen e përkthimit, të përkthyesve, teknikave, mbajtësve dhe brendësive, në mungesë të mjeteve, si kohore, ashtu edhe atyre financiare e institucionale.

Është e qartë se mund të pranojmë mendimet dhe rrymat që theksojnë se «[...] ne, që për profesion kemi bartjen e mendimit të tjetrit, shpesh e kemi të vështirë t'u japim shpjegime të tjerëve, ngase nuk e kemi mbështetur ndjeshmërinë tonë me një mendim. Ndoshta ndihemi më të lirë kështu, pa teorizim të vetëdijshëm»⁽¹⁾, por të ndihesh i lirë, pa teorizim, do të ishte e mundshme pasi të fitohej një bagazh i pasur teorik dhe një kulturë e gjerë dhe e thellë. Përndryshe, nuk bëhet përkthyes çdokush që dëshiron, kur të dëshirojë, si të dëshirojë, për të bërë atë që të dojë.

Përkthimi është më i ndërlikuar sesa duket në shikim të parë. Është vështirë të përcaktohet në një teori të vetme, sepse, për nga përkufizimi, ai është një zhvillim, meqë synon hapjen dhe përparimin. Ai ecën me hapat e vet, të ngarkuar me histori dhe me trashëgimi, sepse kemi të bëjmë pikërisht historinë dhe trashëgiminë e njerëzimit, për t'ia përcjellë në të ardhmen njerëzimit.

Midis teorive që përpiqen ta përkufizojnë përkthimin është ajo e Ljudsknov, që veçon përkthimin njerëzor dhe përkthimin mekanik, ndërsa shkencën e përkthimit e bën «degë të semiotikës» ose ajo që saktëson se «studimi i përkthimit tradicionalisht del nga ajo e gjuhësisë, në rast nevojë nga ajo e letërsisë krahasuese»

«Antropologët, sociologët ose psikologët socialë, si duket nuk po interesohen në këtë dimensionin e takimit me tjetrin. Pa dyshim, këtu kemi një shembull tipik, kur çështja preket vetëm përbrenda një disipline, ndërsa elementet e përgjigjes, madje të zgjedhura, mund të konsiderohen vetëm duke kaluar kufij (disiplinorë) hermetikisht të mbyllur»⁽²⁾.

Kjo na shpie edhe një herë drejt një gjendjeje, ku të shtyrë nga dëshira për ta «përcaktuar» dhe «përkufizuar» një degë, ne e harrojmë atë që më së shumti i nevojitet përkthimit, nga përkufizimi dhe për ta luajtur një rol, e që do të mund të përmbledhë me një fjali të vetme: hapjen ndaj tjetrit.

1. Jean-Claude G  mar, Traduire ou l'art d'interpr  ter, Qu  bec, Presse Universitaire de Qu  bec, 1995, p. 5.

2. Guy Jucquois, Pour une typologie de la traductibilit  , Lausanne, CTL, 1991, p. 4.

Përkthimi propozon një hapje, që njëkohësisht dallon nga roli i tij, që të ngulitë një vepër, duke i dhënë asaj një lëvizje drejt tjetrit, ose drejt historisë së vet, si një imazh që reflekton vetveten. «Puna e përkthyesit gjithashtu shtrон dëshirën për të arritur një stabilizim të veprës». Ja, pra, ajo që pikërisht nuk është pjesë e fatit të veprës! Sepse, as historia e krijimit të saj, as historia e mbijetesës së saj, nuk e drejtojnë një vepër drejt stabilitetit, pohon Paul de Man. I kuptoj mirë këto mendime, duke shtuar njëkohësisht që, edhe nëse një vepër nuk është e drejtuar drejt një stabiliteti, përkthimi e zgjeron, madje edhe e universalizon përfaqësimin e botës.

Sikur shprehja që thotë «sa më i thellë lumi, aq më i qetë», edhe përkthimi shërben si urë midis lumenjve, për t'i prekur shpirtat në thellësi, për t'ua mundësuar komunikimin njerëzve dhe për ta «stabilizuar e thelluar» kuptimin.

Sepse, përtej kristalizimit të teorive të përkthimit, do t'ia vlente të rikujtonim se një teorizim të vetmin qëllim ka që të jetë në shërbim të një praktike të vërtetë të përkthimit, ngase çdo ndarje shkon përtej vetë përkufizimit të përkthimit: hapjes. Po, vetëdija e «ligjit të përkthimit» ka ekzistuar gjithnjë, së paku që nga Shën Jeronimi, edhe pse ky «ligj» është shkelur shpesh. Perot d'Ablancourt, promovues i «Belles Infidèles», pra i përkthimeve letrare etnocentriste dhe përshtatëse, pranonte edhe ai ekzistencën e këtij «ligji», nga i cili nxjerr si përfundim logjik jo rregulla, por një sistem të «parimeve rregulluese», për ta përdorur gjuhën e Kantit»⁽¹⁾. Këto parime rregulluese njëkohësisht janë një siguri për të ardhmen e përkthimit, një hapje drejt së ardhmes, me të kaluarën si garanci.

Për ta përmyllur këtë pjesë, «studimi i së kaluarës së profesionit tonë do të kontribuojë në legjitimimin e përkthimit si disiplinë autonome, e aftë për t'u përkufizuar vetë, për të pasur një fjalim sui generis. Ai tashmë është emërtuar si: «përkthimologji» (anglisht, «translation studies»). Kjo degë e re nuk mund të synojë ndonjë të ardhme, nëse nuk mund të ushqehet me njohuritë e së kaluarës, për t'u mbushur energji me modelet e vjetra»⁽²⁾.

1. La Traduction littéraire, scientifique et technique, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, p. 14.

2. Delisle, Les traducteurs dans l'histoire, Otaëa, Editions Unesco, 1995, pp. 14-15.

1.3 «Llojet» e ndryshme të përkthimit (me shkrim dhe me gojë)

«Nëse përkthimi i specializuar duhet të jetë i besueshëm, përkthimi letrar duhet të jetë besnik i origjinalit, që do të thotë domosdoshmërisht: fjalës, përmbajtjes së tij. Besnikëria ndaj tekstit ose përmbajtjes, nuk do të thotë literalizëm primar, dhe më përpara pranon mijëra forma subtile të transformimit. Prandaj, ajo nuk i përket asnjë metodologji»⁽¹⁾

Ka disa dyzime midis përkthimit me gojë dhe me shkrim, përkthimit letrar dhe teknik, ose përkthimit dhe interpretimit, «por çifti më i njohur është me siguri ai i përkthimit letrar dhe teknik». Anoine Berma (Drejtor i Qendrës Amyot), ka theksuar mirë se «ky i fundit, që parapëlqen ta quajë «të specializuar», veçohet nga përkthimi letrar, sepse, para së gjithash, është një mjet komunikimi, përderisa rivali i tij është medium, që do të thotë mjet komunikimi dhe letrar»⁽²⁾.

Ky kategorizim, që do ta shohim më tutje, nuk është i lehtë, si në mënyrën e përkthimit, në pagesat, ne përdorimin ose edhe aftësimin e përkthyesve. Një takim midis ngjashmërive, por edhe veçori buthtojnë përreth përkthimeve, ose dalin nga to, ndërsa kufizimet nuk janë qartësisht të përkufizuara, për arsyen e thjeshtë që çdo përkthim, qoftë ai letrar qoftë teknik, shkencor a i specializuar, përbën në vete një përçapje të përbashkët për të gjithë : përkthimin. Ekzistojnë veçori midis çdo përkthimi, pak sikur nuancat e së njëjtës ngjyrë të një pikturë, që dëshiron ta paraqesë realitetin më të afërt të mundshëm.

Mirëpo, para së gjithash, është piktori dhe mënyra se si e mban brushën, si i përdorë ngjyrat dhe si i zgjedh nuancat, ai që e krijon pikturën.

«Të themi se nuk përkthehet Shekspiri si një raport i OKB-së ose si tekste të tjera «joletrare», kjo është e qartë; por kjo, megjithatë, nuk do të duhej ta fshehte pamjen e përgjithshme: në lojë hyjnë të njëjtat veprime. Vetëm funksioni dallon: në disa raste, shënjimi informativ do të jetë dominues e në raste të tjera shënjimi është estetik, ku me ç'rast funksionet e këtyra kombinohen....», sipas natyrës së tekstit për përkthim»⁽³⁾. Jashtë kategorizimeve të përkthimeve të përmendura më lart, janë edhe të tjerat, si ajo e Roman

1. La Traduction littéraire, scientifique et technique, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, p. 14.

2. Ibid., p. 4.

3. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, PUF, Que sais-je ?, 2003 p. 67.

Jakobson-it që «dallon tri lloje: përkthimin ndërgjuhësor ose riformulimin (anglisht rewording), përkthimin brendagjuhësor, nga gjuha në gjuhë, apo përkthimin si të tillë, përkthimin ndërsemiotik, që «ka të bëjë me interpretimin e shenjave gjuhësore me ndihmën e sistemeve të shenjave jogjuhësore»⁽¹⁾. Në fjalitë vijuese, qëllimi është të krijohet një listë që do t'i vërë në pah disa veçori të llojeve të ndryshme të përkthimit. Duke e krijuar një listë të tillë, kuptojmë dobinë, mbase edhe domosdoshmërinë e përkthimit. Shumë autorë janë përpjekur t'i kuptojnë dallimet midis gjinive të përkthimit. Me sa duket, Friedrich Schleiermacher, në një tekst të botuar më 1813, *Metodat e ndryshme të përkthimit*, është ai i cili do t'i vendosë themelet e një studimi metodologjik të përkthimit, siç e rikujton M. Berman⁽²⁾.

1.3.1 Përkthimi i «teatrit»

Përkthimi i një teksti teatror, me sa duket, është edhe më i vështirë se përkthimi i poezisë. Këto vështirësi rrjedhin nga fakti se teatri njëkohësisht është i ngarkuar me simbole dhe me një realizëm shumë të hollësishëm, meqë «një stuhi bore në Siberi nuk është e njëjta gjë me një stuhi bore në Alpe»⁽³⁾; sikurse që shiu, i cili është aq shpesh i pritur në rajonin e gjyshërve të mi, nuk e ka kuptimin e njëjtë me shiun e garave shkollore. I njëjti shi, që i gëzonte gjyshërit e mi, i bënte të mërzhitur shokët e mi. Hyjnë pra në lojë interpretimet, kuptimet, joverbalja ose gjuha e trupit, skenari, trekëndëshi autor-regjisor-aktor, publiku, pra një kontekst i madh.

Në këtë situatë komplekse, «përkthyesi i teatrit, pra, ndodhet midis autorit dhe regjisorit», «ai përkthen shpeshherë për një bashkëbisedues të pamëshirshëm» dhe i ekspozohet «një rishqyrtimi të përhershëm»⁽⁴⁾.

Marrëdhënia autor – regjisor – aktor – përkthyes – publik, vërtet mund të ketë interferenca, keqkuptime ose kritika, por teatri është i ngarkuar sidomos me emocione.

1. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, PUF, Que sais-je ?, 2003 p. 67.

2. La traduction littéraire, scientifique et technique, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, p. 14.

3. Traduire le théâtre II, Séminaires du CTL, Lausanne, Edité par Brigitte Burger-CTL, 1995, p. 10.

4. Traduire le théâtre II, Séminaires du CTL, Lausanne, Edité par Brigitte Burger-CTL, 1995, p. 8.

Çehovi «nuk besonte se shikuesit jorus mund ta kapnin kuptimin e plotë të Kopshtit të qershive [...], aq shumë, sa që i vinte keq që nuk mund ta pengonte përkthimin e tij dhe prodhimin e tij jashtë vendit»⁽¹⁾.

Fatmirësisht që përkthyesi, ky «ri-shkrimtar», shpeshherë kishte kurajën të na e siguronte kohën e katërt të shkrimit: kohën e leximit, pastaj kohën e shkrimit, të rrëfimit dhe të historisë.

1.3.2 Përkthimi i «eseve»

Esetë, si të gjitha fjalimet politike, paraqesin një vështirësi të madhe gjatë përkthimit: ato përçojnë mendime, reflektime dhe qëndrime, që shpeshherë kanë referenca të aktualitetit të menjëhershëm, të pathëna, ndoshta edhe një gjuhë të dyfishtë. Esetë nuk ballafaqohen me mesazhin e tyre, ato janë të ndërlidhura me një kontekst mjaft të përpiktë. Qëndrueshmëria e eseve është dëshmuar nga përkthimet, sepse «nëse përkthimet ndryshojnë, kjo është një çështje historike. Vepra ekziston në vetvete, por çdo epokë ka një vështrim të ndryshëm ndaj një vepre. Ky vështrim është përkthimi»⁽²⁾. Mirëpo, «ka ese, si ato të Camus-ë, për shembull, që nuk janë askund të krahasuara me fjalimet politike, që kanë të bëjnë me aktualitetin e menjëhershëm dhe pa refleksione mbi pasojat», nënvizon Doris Jakubec.

1.3.3 Përkthimi i «poezisë»

Shpeshherë, qoftë për t'i arsyetuar ngurrimet kundrejt përkthimit, qoftë nga shqetësimi për një bartje më të mirë të mesazhit ose nga frika që të preket origjinali, përkthimi i poezisë merret si shembull i pamundësisë që përkthimi të japë një tekst origjinal. Monique Laederach, duke folur për papërkthyeshmërinë e poezisë dhe idesë së përhapur që e shoqëron atë, shkruan se «është edhe çelësi i dekurajimit, ku rrëshqet përkthyesi, sado me përvojë të jetë ai, kur përpiqet ta përkthejë ndonjë poezi. Të gjitha, për ta thënë të drejtën, ose gati të gjitha i kanë rezistuar: finesa e kuptimit, sikurse edhe muzika, konvergjenca e simbolizmave, sikur edhe evidenca e rimave. Si duket, në mes të origjinalit dhe poezisë së përkthyer ekzistojnë hapësira ndëryjore, që asgjë nuk do të mund t'i plotësojë»⁽³⁾. «Po, të përkthehet poezia, rima e saj, mesazhi i saj i thellë, përmbajtja e pasur dhe e përpunuar, polifonia e saj, ritmi i saj, ose heshtjet e saj, duket mision i pamundshëm për secilin përkthyes ose duket i mundshëm vetëm transponimi krijues»⁽⁴⁾.

1.Ibid., p. 5.

2.Ibid., p. 6.

3.Monique Laederach, Traduire la poésie, CTL, Lausanne, 1992, p. 3.

4. Michaël Oustinoff, La Traduction, PUF, Que sais-je?, Paris, 2003, p. 61.

Çdo përkthyes me përvojë duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë, para se të hidhet në një aventurë të tillë, atë të përkthimit të poezisë, të transmetimit të ritmit dhe të tingujve, nga një gjuhë në tjetrën, nga një shoqëri në tjetrën, nga një kod në tjetrin, nga një hapësirë në tjetrën ose nga një kohë në tjetrën. Por, poezia, e vërteta, ajo që është e shkruar në një gjuhë, por jo vetëm për një gjuhë, mund të përkthehet, sepse për nga përkufizimi, ajo e ka një ritëm universal dhe i kushtohet një hapësirë leximi të hapur. «Comme d’habitude», në frëngjisht është kënduar edhe nga Frank Sinatra, Elvis Presley edhe nga Gipsy Kings, pa e dobësuar sharmin e dëgjimit të një kënge, melodie, teksti dhe ritmi, por shumësia e gjuhëve dhe e folësve i japin bukurinë e saj poetike. Një përkthyes poezie e di mirë se puna nuk është e lehtë dhe se «një poezi origjinale, do të mbetet gjithmonë unike – është vetë përkufizimi i saj. Ajo strukturalisht do të mbetet unike edhe përbrenda kontekstit të saj kulturor. Dhe ajo që shkakton poezia e përkthyer tek ne; lexues ose përkthyes, nuk është statike, nuk është e vdekur; është, sikurse e thotë Michel de M’Uzan, intuitë e një «situate e të qenit në botë të një qenieje me dëshirë, që, në vetvete, paraqet një realitet të ri. Kemi të bëjmë, pra, me një lëvizje, me një dinamikë dhe me një përkallim të kësaj dinamike. Poezia origjinale do të mbetet pezull aty ku është».

Pranimi se përkthimi i një poezie është i pamundshëm, është edhe një mënyrë për ta shënuar pastaj rrugën drejt së mundshmes, drejt mënyrave se si të bëhet e mundshme. Nëse poezia është sfida e përkthyesit, përkthimi i saj është arsyeja e të qenit e të gjithë përkthyesve të mirëfilltë.

1.3.4 Përkthimi dhe «proza»

Përgjatë shekujve, proza ishte shtylla, vetë arsyeja e ekzistencës së një pjese të madhe të përkthyesve. Personat më të pasur komunikonin përmes leximit. Sot, lloje të ndryshme të përkthimit e zënë më shumë skenën se përkthimi i prozës. «Për shkak të këtij ndryshimi, përkthimi letrar, i cili e dominonte dikur përkthimin me shkrim, tani zë vetëm një vend shumë më të vogël në numrin e konsiderueshëm të dokumenteve të përkthyer...»⁽¹⁾ Duket se përkthimi i prozës zotërohet më shumë se përkthimet e tjera, si i poezisë, i teatrit, i lojërave, i fjalëve etj., për faktin e vetë natyrës së saj, ndoshta edhe për shkak se ka më shumë përshkrime, më shumë përmbajtje objektive dhe kuantitative.

1. Amparo Hurtado Albir, *La Notion de fidélité en traduction*, Paris, Didier Erudition, 2003, p. 10.

Originali dhe përkthimi shpesh nuk e kanë numrin e njëjtë të fjalëve, strukturën e njëjtë ose paragrafët e njëjtë. Si shembull, Michaël Oustinoff në «Përkthimi» paraqet një tekst anglisht, në origjinal, «numëron një fjali të vetme me 60 fjalë», përderisa për ta përkthyer në frëngjisht, një student përdor 75 (+20%) fjalë», ndërsa një «mësimdhënës deri në 94 fjalë (50%)». Për ta përkthyer, do të thuhet se «frëngjishtja është gjuhë më «analitike» se anglishtja, përdor më shumë fjalë» dhe që «dallimet e tilla tejkalojnë kuadrin e rregullimeve vetëm e vetëm gjuhësore »⁽¹⁾. Përkthimi i prozës, shumë më shumë se përkthimet e tjera, duket të jetë më pak i vështirë, më pak i kritikuar dhe më i lirshëm, për të mos thënë më i shthurur, sepse hyn në lojë shprehja e famshme «e pabesa e bukur»; ku, kësisoj, më lehtë pranohet ideja se «çdo përkthim, qoftë ai «alograf» ose «autorial», e përbën, pra, një version plotësisht të veçantë nga vepra prej së cilës buron»⁽²⁾.

1.3.5 Përkthimi i «lojës së fjalëve»

Sipas Todorovit, «loja e fjalëve shkon kundër përdorimit të fjalëve në mënyrën e përdorimit gjatë të gjitha rrethanave të jetës së përditshme»⁽³⁾.

Sipas Jacqueline Henry, mund të kategorizohen katër lloje të mëdha të mënyrave të përkthimit të lojës së fjalëve, që quhen: «përkthimi izomorf», «përkthimi homomorf», «përkthimi heteromorf» dhe «përkthimi i lirë»⁽⁴⁾.

Loja e fjalëve duket më e papërkthyeshme se poezia. Aq më tepër se terminologjia që e rrethon lojën e fjalëve paraqet një mori fjalësh, saqë duket se edhe më kompetentët nuk arrijnë ta zotërojnë. Çdo përkthyes, së paku ai fillestar, duhet të shoqërohet nga një fjalor i specializuar, për t'i nxjerrë përkufizimet, që imponohen lidhur me terminologjinë që përbëhet nga fjalët profesionale ose të përdorimit vendor, shkencor apo arkaik: «Akronime, Akrostik, Alografe, Anagrame, Antonim, Palindrome, Plurivalencë, Paronomasi, Paronimi, Imitim ose Gafë»⁽⁵⁾.

Duke e ditur se «fusnotat janë turpi i përkthyesit» dhe përballë një loje fjalësh, si: «Plus il fonce, plus il brille», personalisht mbetem i pafuqishëm para lexuesve nëse duhet ta përkthej në gjuhën shqipe.

Por, përkthimi do të përcjell së paku dallimet para së papërcjellshmes.

1. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, PUF, Que sais-je ? 2003, pp. 98-99.

2. Ibid., p. 86.

3. Jacqueline Henry, La traduction des jeux de mots, St-Etienne, Presses Sorbonne Nouvelle, 2003, p. 7

4. Ibid., p. 14.

5. Ibid., pp. 287-293.

Fjala e «përkthyeshme» nuk do të duhej të përdorej vetëm për shkak të disa situatave të veçanta, sepse të shumtë janë ata ose ato që, të gëzuar që kanë gjetur një përjashtim, e bëjnë rregull në dëm të përkthimit dhe të komunikimit, si akt përfundimtar të saj. Sepse, përkthyesi dhe përkthimi zhvillohen pikërisht në këto lloje sfidash. Dhe lidhur me këtë temë, «Gödel, Escher, Bach (...), që disa botues francez kishin refuzuar t'i blinin për shkak të «përkthyeshmërisë», janë përkthyer, ndër të tjera, nga anglishtja në gjuhën kineze. Mund ta marrim me mend se çfarë problemesh mund të paraqesë *à priori* transponimi i një akrostiku ose i një palindromie gjigante në një gjuhë tjetër me ideograme! Por, ato, megjithatë, u zgjidhën»⁽¹⁾.

1.3.6 Përkthimi i «librave shkencorë»

Librat dhe tekstet shkencorë janë pjesë e përkthimeve që «janë evidente», sepse janë aq të nevojshëm, sa edhe të dobishëm. Vështirësia kryesore qëndron në mjetet financiare dhe në burimet njerëzore. Duke ditur se bota anglosaksone boton një pjesë të konsiderueshme të hulumtimeve shkencore, kuptohet lehtë se janë librat në anglisht që përkthehen në gjuhë të tjera. Për më tepër, shpeshherë përkthimet bëhen nga tekstet tashmë të përkthyera në anglisht.

Në ish-Jugosllavi, pothuajse të gjitha përkthimet e teksteve shkencore në shqip rridhnin nga gjuha serbokroate dhe jo nga origjinali, për shembull, nga anglishtja.

Më të kujdesshëm ndaj saktësive sesa ndaj stilit, përkthyesit e teksteve shkencore janë më pak objekt debatesh entuziaste, ani se përmbajtja e përkthimeve të tyre është më se e nevojshme për debatet dhe për përparimin e njohurisë.

1.3.7 Përkthimi i librave «fetarë»

Përkthimi i librave fetarë sot është në një pozitë më shumë dytësore, përderisa janë ato përkthime që kanë ndikuar të zhvillohen mendjet, mbase edhe u kanë kushtuar me jetë përkthyesve.

Përkthimi ishte njëkohësisht trampolina për ungjëlizimin, por edhe për reformën, sepse vetëm përmes zgjerimit të njohurive bëhen reformat.

1. Jacqueline Henry, La Traduction des jeux de mots, Saint-Etienne, Presses Sorbonne Nouvelle, 2003, p. 12

Kjo është edhe arsyeja që rikujtojmë «se Augustini e ka ndier prej nga do të vijë fryma e Reformës dhe [...] lehtësisht kuptojmë mosbesimin e Kishës kundrejt përkthimit»⁽¹⁾.

Shumë para Harry Potter-it, referencë e përkthimit të shumë të rinj të mbarë botës, qysh «në fund të vitit 1977, është Bibla e përkthyer në gjithsej 1631 gjuhë (266 krejt Biblën, 420 Dhjatën e Re, 945 së paku një libër të Biblës)»⁽²⁾.

Ripërkthimi është skandaloz që në fillim, sepse e vë në pikëpyetje fjalën dhe tekstin, gjë që nuk bëhet me lehtësi në periudhën e fuqisë së Kishës. Megjithatë, Ungjijtë në greqishten e vjetër qenqëshin qysh atëherë me prejardhje arameike dhe me Jeronimin, me prejardhje ilire, me Stridonin e Dalmacisë, por para së gjithash kozmopolit, «Perëndimi krishterë zbulon ekzgjenezën dhe sidomos skandalin e ripërkthimit. Ripërkthimi i Ungjillit të ri, i bërë nga tekstet greke, është pritur keq, sepse e thyente traditën»⁽³⁾. Ky shembull ilustron vështirësitë e ripërkthimit, pa e harruar «respektin e heshtur» që do të ekzistonte midis përkthyesve, në mënyrë që të mos merret parasysh vazhdimi i përkthimit si një konkurrencë jolojale ose edhe më keq, si një denoncim ndaj një kolegu.

Lidhur me këtë, «gjithashtu do të vërejmë se përkthimi i teksteve të shenjta zhvillohet në botën e krishterë nga shekulli II, e se po ashtu nga kjo periudhë zhvillohen tensionet doktrinuese dhe divergjencat, siç janë gnosticizmi dhe arianizmi»⁽⁴⁾.

Është e qartë se nuk jemi më në të njëjtin kontekst, porse debatet rreth përkthimit të teksteve fetare vazhdojnë të jenë shpërthyesë. Kjo është një gjë pozitive, sepse kjo situatë kontribuon në përmirësimin, si të teknikave të përkthimit, ashtu edhe të mendimeve rreth përzgjedhjes së teksteve. Në këtë rast, po përmendim përkthimin e Biblës, por edhe tekstet e tjera të shenjta, që do të duhej t'u nënshtroheshin diskutimeve të njëjta, në kritikën e tyre dhe në thellimin lidhur me përkthimin ose me përkthimet.

1.3.8 Përkthimi i «broshurave turistike»

Është ndoshta përkthimi i vetëm që njoh, i cili nuk ngre valë, sepse përballë pamjeve me aq dete dhe diell, shpirtrat janë më të qetë dhe komunikimi zë vend. Dhe, punë e madhe, nëse në broshurë «PIZZA» shkruhet me një «z» apo me dy, përderisa adresa dhe çmimi janë të sakta.

1. Michel Ballard, Europe et traduction, Ottaëa, Presses de l'Université d'Ottawa, 1998, p. 17.

2. Jean-Claude Margot, Traduire sans trahir, Lausanne, L'Age d'Homme, 1990, p. 14.

3. Michel Ballard, Europe et traduction, Ottaëa, Presses de l'Université d'Ottawa, 1998, p. 15.

4. Ibid., p. 15.

Përveç një stili zbavitës, broshurat turistike janë pjesë përbërëse të salloneve tona. Duke i shikuar ato, fitojmë përshtypjen se të gjithë banorët e ishullit Bora-Bora flasin shqip, italisht ose frëngjisht. Ka rrezik që bëjmë më shumë lëvizje se pushime. Fuqia blerëse është ajo që i rregullon kompanitë turistike për përzgjedhjen e gjuhëve, jo çfarëdo refleksioni gjuhësor.

1.3.9 Përkthimi me gojë dhe interpretimi

Që prej kohësh, përkthimi me gojë ndoshta është përkthimi i kontaktit *par excellence*. Ai është bërë dhe bëhet nga të gjitha zonjat dhe zotërinjtë e mundshëm. Kush, vallë, nuk e ka provuar, edhe me një anglishte të zbehtë, t'i orientojë udhëtarët e humbur?

Edhe fëmijët përkthejnë, spontanisht.

Mbase, dikur, ata ishin përkthyesit e privilegjuar, si Juste dhe Colombe, këta dy fëmijë të ngarkuar dhunshëm nga ana e «pushtuesve» francezë në Brazil, më 1555, për të shërbyer si përkthyes pranë fiseve indiane, që Rufin e përshkruan aq mirë në librin e tij i cili fitoi çmimin Goncourt më 2001⁽¹⁾. Edhe sot, fëmijët, sidomos ata të emigrantëve, shpesh shërbejnë si përkthyes për prindërit e tyre në fushat sociale, policore ose mjekësore.

Përkthimi me gojë dhe interpretimi, që e synojnë përkthimin e shprehjeve me gojë ose gjuhës së shenjave (nga një gjuhë në tjetrën), nuk janë aspak një nënkategori e përkthimit. Përkundrazi, ato janë të dukshme, ose të dëgjueshme, e sidomos dialogjike.

Përkthimi me gojë paraqet shumë vështirësi. Lidhur me këtë do të përmendja sidomos faktin që është një proces i drejtpërdrejtë dhe ku përkthyesit nuk e kanë paraprakisht as tekstin dhe as një pjesë të tij për t'u përgatitur.

«Problemi i interpretimit të tekstit, shpjegon një gazetare, duket sheshit thelbësor për përkthimin, qoftë ai letrar ose i specializuar. Përkthimi i tekstit është një proces interferencial, që përbëhet nga ndërtimi i hipotezave, duke u nisur nga disa premisa që janë, nga njëra anë, të pajisura nga teksti dhe, nga ana tjetër, të nxjerra nga lexuesi, nga tërësia e njohurive të tij (besime, mendime) të përgjithshme. Si natyra, ashtu edhe përmbajtja e kësaj tërësie dallon nga një lexues te tjetri, nga numri dhe natyra e interferencave, të ndërtuara gjatë interpretimit, edhe ato mund të dallojnë nga një lexues te tjetri»⁽²⁾.

1. Jean-Christophe Rufin, *Rouge Brésil*, Paris, Gallimard, 2001.

2. Louvain, *L'interprétation du texte et la traduction*, édité par Sv. Voegelé, BCILL, 1995, p. 3.

1.3.10 Përkthimi i filmave

Përkthimi i filmave të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, filmave vizatimorë dhe *soap-operave*, ose telenovelave, sot është më i mundshëm për një numër të madh të njerëzve.

Duke qenë i mësuar me përkthime me titrime, jam habitur kur e kam shikuar për herë të parë një film të John Wayne, ku fliste turqisht. Po, John-i hyn në një restorant dhe kërkon prerazi, për ta lagur fytyrën, një *Tchai*, ose një çaj, për ata që nuk janë mësuar me sallonet turke. Çaj ose Whisky, ai kërkon të pijë në të gjitha gjuhët.

Dublimi i filmave njëkohësisht është një shembull i përparimit, por edhe veçmas i një dëshire për ta ruajtur gjuhën, sidomos përballë anglishtes së gjithëfuqishme në kinema. Vërtet, përkthimi i këtyre filmave përmban liri të ushqyera nga veçori, si fetare (çaji zëvendëson whisky-n), ashtu edhe kulturore. Geneviève Comby, në një artikull gazete⁽¹⁾, shpjegon situata ku përkthimi nuk e ndjek doemos tekstin ose fjalët e origjinalit: «Asgjë nuk bëhet në mënyrë zyrtare, nuk ka udhëzime të shkruara, por jetojmë tani për tani një lloj brengje të përgjithshme e cila i shtyn përkthyesit që vetë të vetëcensurohen».

Në këtë artikull, ajo zhvoshk disa shembuj, që pothuajse të bëjnë për të qeshur. Ja disa prej tyre: Fjalja në anglisht: «Do të përfundosh duke u pjekur në karrige elektrike» në frëngjisht përfundon: «Vërtet e ke merituar nëse shkon në burg», sepse shprehja është tepër sadiste për *Ekspertët Miami*. «Ai është mbreti i kretenëve» në anglisht, shndërrohet në: «Ai është një personazh i urryer» në frëngjisht, sepse shprehja është shumë vulgare për serialin *ReGenesis*. «Mercedesi i madh me xhama të ngjyrosur» në anglisht, bëhet «Një veturë e markës gjermane» në frëngjisht, për ta shmangur qëllimin reklamues (24 heures Chrono).

Në Zvicër dhe aq më pak në Kosovë, nuk ka buxhet të mjaftueshëm për përkthimin dhe dublimin e filmave. Në të dy rastet, një pjesë e madhe e këtyre përkthimeve vijnë nga Franca ose nga Shqipëria.

1. Geneviève Comby, «Séries télé: traduites et surtout censurées», *Le Matin*, Lausanne, 18 mars 2007, pp. 78-79.

1.3.11 Përkthimi i teksteve zyrtare (drejtësi, polici, spiunim etj.)

23 gjuhët zyrtare të 27 shteteve të Bashkësisë Evropiane dhe dokumentet zyrtare që duhen përkthyer, ilustrojnë vëllimin shumë të madh të përkthimeve. Vetëm në Evropë, më 2010, sipas një studimi të Commun Sense Advisory (CSA), kostot e përkthimeve ishin rreth 5'306 milionë dollarë ose 41% të tregut botëror, me një ngritje vjetore prej 7.5%.⁽¹⁾

Një nga arsytet e përmendura shpesh nga vlerëtohuesit e shumë shërbimeve të sigurisë të Shteteve të Bashkuara, pas atentateve të 11 shtatorit 2001, ishte mungesa e përkthyesve që do të mund të përgjonin bisedat e kamikazëve. *Kodi Navajo*, filmi me Nicolas Cage, ilustron shumë mirë një situatë, ku gjuha përdoret për të komunikuar informata gjatë Luftës së Dytë Botërore, saktësisht sepse pak njerëz komunikojnë në gjuhën navajo dhe për këtë shkak mesazhet transmetohen pa rreziqe. Interpretja është një shembull tjetër, midis aq shumë filmash të tjerë, ku subjekti i përkthimit është përdorur në kinema; me Nicole Kidman, si një interprete aq e bukur.

Azilkërkuesit në Zvicër, për ta përmendur vetëm këtë shtet, ku gjatë shumë viteve jam ballafaquar me përkthime, shpeshherë janë të heshtur para disa përkthyesve. Me të drejtë ose jo.

Përkthimi i përgjimeve telefonike, marrjeve në pyetje, dëshmitarëve, kërkesave ose ankesave, mbeten ende detyrat kryesore të përkthyesve të mësuar, të cilët ende kanë ditë të bukura para tyre, sepse ata shpeshherë janë të paguar shumë mirë, sidomos në krahasim me përkthyesit letrarë.

1.3.12 Përkthimi i njoftimeve të paketimeve

Në përgjithësi, për të mos thënë gjithnjë, emri i përkthyesve nuk shfaqet në përkthime. Në shtete si Zvicra, problematika e përkthimit të njoftimeve të paketimeve për ushqimin, barnat dhe të gjitha produktet e tjera është shumë më e zhvilluar sesa në shtete të tjera, si në Kosovë, për shembull, ku përkthimi lë për të dëshiruar për pjesën dërrmuese të këtyre produkteve. Gjendja po përmirësohet gradualisht.

1. Source: www.thelanguagetranslation.com/services-industry.html

1.3.13 Përkthimi i reklamave dhe internetit

Lidhur me përkthimet zyrtare, duhen përmendur edhe dokumentet, si: vërtetimet, certifikatat, dokumentet e udhëtimit, aktet civile, diplomat etj.

Reklamat ose fushatat reklamuese të organizatave të fuqishme, që duan dhe që mund të prekin publikun përtej kufinjëve kombëtarë, janë shembuj të tjerë të përkthimeve. Mjafton të blihet një kartë celulari me parapagim, për të konstatuar se gjuha kurde dhe ajo tamule janë në mesin e gjuhëve që ndodhen prapa kartës së telefonit...

Një lloj tjetër i përkthimit, që s' duhet nënvlerësuar, ka të bëjë me fushatat e organizatave të ndryshme sportive ose humanitare.

Interneti dhe të gjitha mediet janë fusha aq të gjera, saqë nuk mund t'i përmendim këtu, me synim një listë, një listë të të gjitha përkthimeve të mundshme, sepse secili ballafaqohet me këto fusha të dijes. Është pikërisht interneti, ky oqean i lëvizjeve, valëve, rrymave dhe gërshetimeve të gjuhëve, që do të jetë gjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm terreni i zgjedhur i çdo hulumtuesi që dëshiron ta thellojë temën e gjuhëve.

1.3.14 Përkthimi «automatik»

Përkthimi automatik është pjesë e ëndrrave që qenia njerëzore ia ka lejuar vetes për ta lehtësuar punën e komunikimit, duke bërë njëkohësisht kursime aftësimesh, parash dhe kohe. E. Cary thoshte: «fjalori është elementi i parë i mekanizimit të përkthimit»⁽¹⁾. Në kohën e internetit, fjalori nuk është, megjithatë, referenca e përkthimit automatik.

Është e ligjshme të përdoret çdo mjet që e lehtëson kuptueshmërinë, komunikimin dhe këmbimin e mesazheve, me kusht që të jesh i vetëdijshëm se ky mjet duhet të përdoret me shumë kujdes, sepse kufizimet dhe sipërfaqshmëria e tij janë të mëdha. Më ka ndodhur të konstatoj se, në mesin e nxënësve të mi shqipfolës, kisha nxënës që, për ta bërë hartimin e tyre në gjuhën frënge, kishin përdorur mjete gjuhësore nga Google, për të përmendur vetëm këtë motor të kërkimit.

Pa dashur assesi t'i qortoj, i kam përgëzuar për përpjekjen e komunikimit që kishin bërë, duke i trajtuar me ta rreziqet që paraqet veprimi i tyre.

1. Georges Mounin, La machine à traduire, MOUTON-CO, The Hague, 1964, p. 15.

Munda t'ju them që struktura e fjalive të tyre, mund të shkaktonte disa keqkuptime.

Përkthimi automatik, i përdorur si mjet i «ndihmës gjuhësore», shpesh përfaqëson, mbase fatmirësisht, vetëm një pjesë të vogël të vëllimit të madh të përkthimeve. Sipas Michaël Oustinoff, «më 1990, përkthimi automatik përfaqësonte vetëm 0.83% të përkthimeve, kundrejt përkthimeve njerëzore në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara (në Japoni: 2.33%)». Këto rezultate janë siguruar «falë sistemit SYSTRAN, të përdorur nga Komisioni i Bashkimit Evropian»⁽¹⁾.

Sipas Netcraft Ltd, më 2008 kishte 186 milionë faqe të internetit, kundrejt 19.000 në vitin 1995. «Shumëzimi i numrit të faqeve të internetit në gjuhë të shumta, e bën të pashmangshëm përdorimin e përkthimit automatik. Shumica e faqeve të internetit nuk do të ishin përkthyer pa programet e përkthimit automatik», sipas autorit të artikullit⁽²⁾. Kjo formë e përkthimit është subjekt i dyshimeve, për sa i përket besueshmërisë së rezultateve.

1.Michaël Oustinoff, La traduction, Paris, PUF - Que sais-je?/, 2003, p. 104.

2.Pourquoi la traduction automatique:

www.systran.fr/systran/entreprise/technologie/pourquoi-la-traduction-automatique).

Kapitulli 2

**NË VEND TË *SHOKUT KULTUROR*,
SHOKU ME KULTURË,
NËPËRMJET PËRKTHIMIT**

Dallimi krijon frikën, frika pjell përjashtimin dhe përjashtimi përjashton integritetin garantues të kohezionit social.

Kultura? Nacion njëkohësisht aq i largët dhe aq personal. Në fjalorin «Robert Illustré », kultura përkufizohet si një «tërësi e formave të fituara të sjelljes në shoqëritë njerëzore». Kultura, kjo fjalë e gjinisë femërore, që shpreh «zhvillimin e disa aftësive të mendjes përmes ushtrimeve intelektuale të duhura» dhe «tërësinë e njohurive të fituara përmes shkollimit dhe aftësimit».

«Kultura është sikur reçeli, sa më pak që kemi, aq më shumë e shtrijmë», thoshte një i panjohur.

«Kultura dhe shpirti janë si një parashutë, nëse mbeten të mbyllura, goditja drejt tjetrit, drejt tokës, është e madhe», thoshte një tjetër i panjohur.

«Sa më i thellë lumi, aq më i qetë...», thoshte gjyshi im. E them dhe e shkruaj po ashtu dhe unë.

Sa më shumë zgjerohen njohuritë e përbashkëta, sa më shumë thellohen ato, aq më tepër qetësohen shpirtrat tanë dhe tronditja është më e vogël. Tronditja kulturore bëhet një tronditje e kultivuar.

Nëse lumi është i thellë, shtrati i tij nuk përmbytet. Andaj, ai ushqen tokën, e cila pastaj na ushqen neve. Po ky lumë edhe mund të përmbytë dhe t'i shkatërrojë të mbjellat.

Kultura është një nicon aq i gjerë, saqë askush nuk mund të pretendojë ta zotërojë tërësinë e aspekteve intelektuale dhe artistike, pra ta zotërojë tërësisht një kulturë. Atëherë, kush mund të jetë dykulturore, shumëkulturore, ndërkulturore, plurikulturore ose polikulturore dhe kështu të pretendojë të ketë disa kultura, nga shumë kultura?

Modeli shumëkulturore e ka bërë rrugëtimin e tij, shpeshherë duke u prapsur. Është koha të përmendet kultura për ta shmangur getoizimin dhe «muret kulturore e gjuhësore».

Komunikimi nuk është zgjidhja e kulturës, kultura është zgjidhja e komunikimit.

Kultura është nicon metafizik dhe universal. Njohuritë janë lënda e saj.

Kultura nuk është pronësi. As individuale dhe as kolektive. Kultura nuk është e trashëguar individualisht ose kolektivisht, ajo është një trashëgimi individuale dhe kolektive, njëkohësisht.

Fatmirësisht që nuk trashëgojmë nga kultura, se, përndryshe, marrëzia do ta kishte kërkuar pjesën e saj të trashëgimisë.

Kultura nuk është në gjendje të ngurtësuar, e trashëguar gjenetikisht, me mundësi të vetme: modifikimin gjenetik, ndoshta edhe klonimin, dhe ashtu

të krijojë kushte jetese «in vitro». Organizmi jeton «in vivo».

«Nuk ka njeri të kultivuar. Ka vetëm njerëz që kultivohen», thoshte Mare-shali Foch. Çdo ditë dhe jo vetëm ditën e lindjes së tyre ose të ditëlindjes së tij.

Kundrejt pyetjes «cilës kulturës i takon?», parapëlqej «a është i kulturuar?» «Pikëpyetjet janë universale, përgjigjet janë kulturore», pohon astrofizikani Hubert Reeves⁽¹⁾.

Nuk ka shkencë dhe përkthim pa pikëpamje. Njerëzit nga mbarë bota sjellin gjithashtu pikëpamjet e tyre, duke e zgjeruar dhe duke e pasuruar vizionin e shoqërisë së mikpritjes, e cila pastaj atyre u hap horizonte të reja.

«Nuk ka kultura pa dallime dhe pa pika të përbashkëta, do të thotë pa universalitet. (...) Ekziston një luhatje e vazhdueshme dialektike midis njërës dhe tjetrës, e cila themelon dinamikën e historisë kulturore. Unë dua të jem në këtë histori. Nuk dua të jem një sy që do t'i vëzhgonte këto bashkësi njerëzore, sikur që vëzhgojmë insekt», ka shkruar Erica Deuber Ziegler.⁽²⁾

Kultura nuk shumëzohet, por transmetohet, sepse ajo është e përbërë nga shumë elemente të njohurive: për shembull, a nuk thuhet kulturë gastronomike, rrobash, fetare, arkitekturore, e punës, fizike, gjuhësore, seksuale, artistike, ndërmarrëse, institucionale etj...

Nocioni shumëkulturator na e kujton një fenomen fizik, si tullat që i vëmë njëra mbi tjetrën për të ndërtuar mure ndarëse midis njerëzve.

Me mjetet e komunikimit të sofistikuar, informatat, njohuritë, përvojat dhe dijet qarkullojnë shpejt. Kjo është e re si fenomen shpejtësie, por nuk është e re si fenomen globalizimi, globalizimi kulturator.

Kur mendon se Marko Polos i janë dashur muaj të tërë për t'u kthyer nga Kina me shpageta.

Përkthimi, ose përkalimi përmes kulturës, kultivon, shndërron «shokun kulturator në shok të kultivuar».

1. Hubert Reeves, astrophysicien, interview, La Bonne Nouvelle, 15. 11. 2006, p. 3.

2. Erica Deuber Ziegler, historienne: «Au quai Branly, j'ai eu honte pour Genève», L'Hebdo, 15. 2. 2007, p. 69

Kapitulli 3

**ASPEKTET SHOQËRORE MATERIALE DHE
INSTITUCIONALE TË PËRKTHIMIT**

3.1 Statusi i përkthyesve

«Ta bësh librin e përkthyer një instrument humanizmi, paqeje dhe përparimi - kjo është punë fisnike», Pierre-François Caillé (1907-1979), Themelues dhe kryetar i parë i Federatës Ndërkombëtare të Përkthyesve

«Përkthyesi gjerman i Umberto Eco-s, duke u shprehur në emër të kolegëve, theksonte pak kohë më parë: shumë shtëpi botuese letrare mbijetojnë falë përkthyesve, përderisa përkthyesit nuk mund të jetojnë nga puna e tyre. A është bash puna e tyre t'i ndihmojnë financiarisht botuesit?»⁽¹⁾

Gjatë Kuvendit të fundit të përkthimit letrar në Arles është saktësuar mirë se përkthyesit fitojnë vetëm 2% nga çmimi i librit për «një shpërblim të mjerë, për një punë të lodhshme, të domosdoshme»⁽²⁾. Kjo fjali përmbledh vetë gjendjen e përkthyesve, që nuk duket aspak e kënaqshme në planin e sigurisë së pagës dhe sigurisë profesionale, pak sikur punëtorët e përkohshëm të audiovizuales.

Ngase nuk janë mjaftuar me një emërtim të ngarkuar, të pasur, të thellë dhe të domosdoshëm në kuptim, përkthyesve ua kanë dhënë disa nofka, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen. Në fakt, Pushkini i thërriste që atëherë «kuajt tërheqës të kulturës»; shumë para tij, Pierre des Maizeaux, i trajtonte si «autorë në rend të dytë»⁽³⁾; të tjerët i quajnë dashamirësisht «një të dërguar dhe një ambasador» ose «ri-shkrimtarë»; më e tmerrshme është, sigurisht: «tradhtarët» (traduttore-traditore) ose spiunët. Marion Graf përmend terma, vërtetë të ashpër, por ndjellës, si: «majmunë, qen qimeddredhur, papagaj, flutur, kontrabandues ose pehlivanë, i mjerë që tërheq mjerimin ose prostitutë luksi, dashnorë të zjarrtë ose gjuhëtarë të mençur»⁽⁴⁾.

Përkthyesi njëkohësisht mbetet një i panjohur dhe një hije, i paguar nganjëherë, para se të zhduket heshturazi. Çdo gjë bëhet sikurse puna e tij turpëron botuesit. Ose ata kanë ndoshta skrupuj për t'i fshehur këta «kuajt tërheqës të kulturës», që zhvillojnë ndërmarrjet e tyre? Po, «përpos në Francë ose në Angli, me disa përjashtime të denja, ku, nëse ballina e librit të përkthyer përfshin emrin e autorit dhe emrin e botuesit, atëherë duhet kërkuar në faqen e titullit brenda, ose më shumë përballë kësaj faqeje, krejtësisht lart ose poshtë, me shkronjat më të vogla të mundshme, sa më fshehur që është e mundur, emri i mjerueshëm i përkthyesit».

1. Marion Graf, L'écrivain et son traducteur, en Suisse et en Europe, Genève-Carouge, Editions Zoé, 1998, p.3

2. Ibid.

3. La traduction littéraire scientifique et technique, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, p.4

4. <http://www.culturactif.ch/livredumois/livrenovembre.htm>

Sot, «në fushën e përkthimit letrar, kjo prirje për fshirjen e identitetit (ndrr. përdorimi i pseudonimeve) mbizotëron sidomos në letërsinë për të rinjtë»⁽⁵⁾.

Përveç mungesës së emrit të përkthyesve në shumë tekste, përfshirë ato teknike, ose nganjëherë përdorimi i pseudonimeve, përkthyesi, që është shpeshherë lexuesi i parë i një teksti në një gjuhë të huaj, kryen një punë në prapaskenë, pak të dukshme, por të domosdoshme për përzgjedhjen dhe jetën e teksteve.

Lexuesi i zgjedhur i një shtëpie të madhe botuese në Francë përmend faktin se «përkthehet vetëm 5% nga ajo që kalon në duart e tij, gjë që përputhet edhe me gjysmën e librave që rekomandohen» ⁽²⁾.

Në konceptimin e një antologjie *Hënore e Zvicrës*, që kam botuar në 2004, më është dashur të lexoj rreth njëqind vepra, për t'i përzgjedhur në fund 9 prej tyre për përkthim. Pa përmendur, si shembuj, 9 citimet që shoqërojnë çdo tekst; për njërin prej tyre më është dashur të kërkoj edhe në vetë arkivat e autorit, përgjatë dy javësh, duke lexuar 140 letra të lexuesve, për t'i përzgjedhur 9, ose një faqe e gjysmë dhe dy javë pune të vështirë. Pa harruar 84 letrat, që më është dashur t'i shkruaj për t'i siguruar 9 të drejtat e autorit.

Dhe, nëse ndokush dëshiron të dijë se cila është rregulla sa u përket të drejtave të autorit, vetëm mund t'i them se vërtet ekzistojnë rregulla, por sa i përket pagesës ka vetëm një rregull: nuk ka rregull.

«Në realitet, marketingu ndërkombëtar ka nganjëherë arsytet e tij, që arsyeja nuk i njeh»⁽³⁾. Në kuadër të përkthimeve, duket e vështirë të vendosen rregulla të përpikta, edhe pse çmimet për fjalët, rreshtat ose faqet qarkullojnë në shumë organizata dhe institucione të specializuara për përkthim; çmime parësore dhe ekonomike ekzistojnë gjithashtu⁽⁴⁾.

Madje, kur flitet për të drejtat e autorit, «një lajm i mirë, Sigmund Freud u takon tashmë të gjithëve. Pjesë e fushës publike nga 1 janari 2010, ai i shmanget kështu autoritetit të Shoqatës Ndërkombëtare të Psikanalizës (IPA), e cila deri atëherë i zotëronte të drejtat ekskluzive për t'i përzgjedhur përkthyesit»⁽⁵⁾. Autori i këtij artikulli ironizon lidhur me Freud-in, me faktin se «një armatë e tërë e përkthyesve kanë hequr të zinj të ulla për ta errësuar», por a është ky faji i përkthyesve, nëse një dominim i tillë ishte i imponuar?

1. Alena Vacek, *Approche historique de la traduction littéraire en Suisse*, Lausanne, CTL, 1995, p. 9.

2. Alain Beuve-Méry, «Au commencement est le lecteur», *Le Monde*, 24 juillet 2009.

3. Mathieu Guidère, *La Communication multilingue*, Bruxelles, De Boeck Université, 2008, chap. 3, p. 57.

4. <http://traductions.3wi.org/traductions/prix.php>

5. Michel Audétat, «Sigmund Freud appartient à tout le monde», *L'Hebdo*, Lausanne, 28 janvier 2010, p. 73.

Në qasje gjuhësore të problemeve të përkthimit, autorët vërejnë «që nuk është ideja të parashtrijë rregulla të përkthimit, por të sjellin elementet që mundësojnë të analizohen kontrastet midis dy gjuhëve». Ata flasin kështu për «praktikën intuitive të përkthimit»(1). Futbollistët e tërë botës do të mund ta kuptonin më mirë një përkthyes, që duhet të ushtrojë fort për t'u ballafaquar me situata të ndryshme gjuhësore, siç bëjnë edhe ata vetë përballë gjuhës së trupit, për të reaguar sa më mirë për të mos marrë gola. Për përkthyesin, një gol i vetëm: të shënohen pikë përballë publikut, ose përballë lexuesve, nëse e parapëlqeni.

3.2 Shoqatat e përkthyesve

Shqetësimi për të mbrojtur dhe për ta bërë të njohur punën e tyre, për t'ia rritur vlerën dhe për ta bërë të dukshme, i ka nxitur përkthyesit të organizohen dhe t'i krijojnë shoqatat e tyre. Bashkimi ishte mënyra më e mirë për t'u forcuar. Ishte e domosdoshme.

Imagjinoni pa përkthime kontrollet ajrore ose detare, doganat, spitalet, policinë, mediet audiovizuale, shërbimet sekrete ose informatat e përditshme?

«Dhjetëra mijë përkthyes të rigrumbulluar në kuadër të 73 shoqatave anëtare të federatës sonë, nuk ndalen së punuari për t'i qëndruar besnik këtij misioni», mund të lexojmë në «Autour de la tâche du traducteur»(2). Si në planin ndërkombëtar, si, për shembull, në Federatën Ndërkombëtare të Përkthyesve (www.fit-ift.org), ashtu edhe në planin kombëtar, me Shoqatën Kanadeze të Përkthimologjisë (www.uottawa.ca), American Translators Association (www.atanet.org) ose Shoqatën Frënge të Përkthyesve (www.sft.fr), gjithnjë e më shumë ka organizata që i vendosin themelet e një institucioni që nuk është asgjë tjetër, veçse motra binjake e Kullës së Babelit, por të një kulle që komunikon, që do t'i japë kuptim këmbimit të gjuhëve, që nuk i redukton dallimet gjuhësore, por i bën të pasura dhe të kuptueshme.

Repertori i parë botëror i historianëve të përkthimit, i cili daton nga viti 1991,(3) është një hap i parë, por mbetet një rrugë e tërë për t'u bërë, që gjurmët e përkthyesit të jenë ura në rrugët që ka vendosur si cak për t'i kaluar.

1. Hélène Chuquet & Michel Paillard, *Approche linguistique des problèmes de traduction*, Paris, Ophrys, 1987, p. 5.

2. Delisle, *Les Traducteurs dans l'histoire*, Ottawa, Editions Unesco, 1995, p. 13.

3. Ibid., p. 14.

3.3 Aftësimi i përkthyesve

Aftësimi i përkthyesve ka përparime në shumë vende të Evropës.

Madje nga shtatori 2010, një Master për përkthime letrare ekziston në Universitetin e Neuchâtel në Zvicër. Një Master për përkthime është po ashtu pjesë e projekteve universitare në Kosovë, që nga vjeshta e vitit 2010.

Aftësimet universitare, si Shkolla e Përkthimit dhe e Interpretimit të Universitetit të Gjenevës; ekzistojnë me dhjetëra vjet. Shkolla e Gjenevës, e themeluar më 1941, është një nga më të vjetrat në botë⁽¹⁾, sepse është e lidhur ngushtë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Sipas përkthimit letrar, shkencor dhe teknik, që më 2001, «Aftësimet profesionale të nivelit universitar janë krijuar në mënyrë progresive, si në Spanjë, Holandë dhe Francë»⁽²⁾.

Qendra e Përkthimit Letrar e Universitetit të Lozanës (<http://www.unil.ch/ctl>), e ilustron mirë gjendjen që «do t'i takojë universitetit për ta administruar njëkohësisht mësimin e përkthimit të teksteve të specializuara dhe për ta luajtur rolin e promovuesit të komunikimit dhe të rojës së tradicionalizmit. Të dihet të bartet kjo përgjegjësi e dyfishtë, duke e refuzuar teknologjizimin e mësimin të përkthimit të veprave (përmes shkencës së gjuhës dhe letërsisë), kjo është sfida kryesore që i del përballë dhe që ka të bëjë me vetë thelbin e universitetit, si vend i transmetimit të universales»⁽³⁾.

Nëse duket e domosdoshme të pranohet dobia e aftësimit të përkthyesve, mund të ketë kjo një anë tjetër: duke e specializuar tepër profesionin, mund të ballafaqohemi me një «elitë sektare», që do ta ketë kënaqësinë dhe pushtetin të përzgjedhë tekste për përkthim, duke i privilegjuar vetëm «shokët dhe shoqet», duke imponuar njëkohësisht tekste dhe stile që do t'i jepen vetëm një rrethi të ngushtë dhe të shkëputur nga realiteti i lexuesve. Ajo që më duket e rëndësishme, është të luftohet për një mirënjohje, para së gjithash, të profesionit të përkthyesit; pastaj do të krijohen aftësimet, sepse, përballë kërkesave në kuptim të cilësisë, kërkesave më të mëdha të publikut për të lexuar tekste të përkthyer mirë, ku duhet shkruar dhe duhet «thënë pothuajse e njëjta gjë» (*Dire quasi la stessa cosa*), për të mos e rimarrë këtë shprehje të Umberto Eco-s.

1. <http://www.unige.ch/eti/index.html>

2. La Traduction littéraire scientifique et technique, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, p. 3.

3. <http://www.unil.ch/ctl>

Si të mos thuhet pothuajse e njëjta gjë me një leksik abstrakt, që e shoqëron përkthimin?

Shtimi i terminologjive të ndërtuara nga secila skuadër e izoluar, është e tillë sa që ndërkuptimi kanoset, në nivelin e vetë hulumtuesve - dhe është pothuajse joekzistent përtej rrethit të tyre të vogël. Vetë fusha anglo-saksone do të kërkonte një fjalorth, me definicione dhe sinonime të termave. Shkollë për shkollë»⁽¹⁾.

Jemi të vetëdijshëm se «njohja e profesionit të përkthyesit, objekt i një aftësimi të njohur nga të tjerët dhe i marrjes së diplomës në shtete të ndryshme, profesion që ia jep një status që ia njohin atij që e ushtron, mbetet ende një betejë»⁽²⁾. Më 2010, profesioni i përkthyesit ka një vend më të volitshëm, mirëpo shqetësimi i tij nuk duket të jetë më tutje mungesa e njohjes, por prirja për një përkthim automatik dhe të informatizuar.

Nuk jam aspak ihtar i idesë se çdo person mund të bëhet «përkthyes». Çdo person shumëgjuhësh mund të ketë qasje në ushtrimin e përkthimeve, por duke pranuar dobinë dhe veçanërisht përkthimin si profesion, publiku, shtëpitë botuese, universitetet, përmes qendrave të tyre të hulumtimit dhe të kompetencave, gazetatat letrare, shkencore dhe teknike si dhe të gjitha organizatat që ballafaqohen me shumëgjuhësinë, mund të paraqesin kërkesa për cilësi. Kjo është edhe arsyeja pse përkthyesi do të kërkojë të aftësohet, që shkollat e specializuara do t'i hapin dyert e tyre për studentët. Më duket një kompromis i mirë, bashkimi i një aftësimi elitari me një qasje të zgjeruar dhe të hapur. Sepse, në publikun e gjerë janë edhe vetë-përkthyesit, këta shkrimtarë, që mendojnë se janë të vetmit zotërues të shkrimeve të tyre dhe që vetëm përkthimi i tyre do ta bartë mesazhin, mesazhin e vërtetë. Davidar Rouz, lidhur me këtë çështje shkruante: «Kuptojmë që vetë-përkthyesi është një përkthyes si një tjetër, ose, ndryshe, se përkthyesi do të duhej të ishte një autor pothuajse si një tjetër, dallimi qëndron në faktin se ai duhet t'i përgjigjet një dokumenti me detyra, të cilat mund t'i jepen nga autori ose nga vetë ai»⁽³⁾. Aty është i tërë arti i përkthyesit, të dijë t'i bashkojë me mprehtësi lirinë, nismën dhe kufizimet e imponuara nga një botues, nga një autor, nga një librari ose nga publiku.

Nëse në çdo profesion, sidomos sot, me këmbimet drastike dhe të shpejta në shumë fusha, aftësimi i vazhdueshëm duket të sjellë përgjigjen më të mirë, në aftësimin e përkthyesve, ai patjetër bëhet i domosdoshëm. Sepse, për nga përkufizimi, përkthyesi është një punëtor i vetmuar, i shoqëruar nga tekstet e tij

1. Georges Mounin, *La Machine à traduire*, The Hague, MOUTON&CO, 1964, pp 197-198

2. *La Traduction littéraire scientifique et technique*, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, p.154

3. Jean Peeters, *La Traduction, de la théorie à la pratique et retour*, Rennes, PUR, 2005, p.13

fjalorët e tij dhe kompjuteri i tij, duke pasur nganjëherë ndonjë thirrje nga porositësi, për t'i bërë presion atij rreth afateve kohore.

Një aftësim i vazhdueshëm do t'i mundësojë të marrë energji dhe ta shikojë botën edhe me sytë e tij, e jo vetëm me ata të autorit nga i cili merr të gjitha vizionet.

Shkolla më e mirë e përkthimit do të duhej të ja tërhiqte vëmendjen përkthyesit të ardhshëm në faktin se [...]«perceptimi i një veprë letrare nuk është një veprim vetëm e vetëm intelektual, por edhe një veprim emocional»⁽¹⁾ dhe «që ka përkthime të përsosura semantikisht, analitikisht dhe që janë vetëm e vetëm pa efekt»⁽²⁾.

Përkthyesi është ai i cili, duke e respektuar para së gjithash besnikërinë e autorit, si dhe aspektin semantik dhe analitik, duhet ta bëjë tekstin tërheqës, të kuptueshëm dhe të këndshëm për lexim.

3.4 Roli i përkthimit në komunikim në shkallë ndërkombëtare

«I ndodhur në zemër të kësaj problematike gjuhësore, përkthimi si instrument i lartë i komunikimit, është vërtet bekimi për popujt...»⁽²⁾

Organizatat ndërkombëtare politike dhe ekonomike, si OKB-ja dhe të gjitha agjencitë e specializuara (si IOM, HCR, OBSH, UNICEF, UNIFEM, UNESCO etj.), Programi Ushqimor Botëror, Organizata Botërore e Tregtisë, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Unioni Postar Universal, si dhe shumë organizata të specializuara, pranë OKB-së ose jashtë OKB-së, duken të jenë nën fatin e përkthyesve, për t'i plotësuar detyrat e tyre dhe për t'i realizuar qëllimet dhe synimet e tyre.

Disa organizata të tjera sportive (për të përmendur këtu vetëm KNO, FIFA, UEFA etj.), ndihma humanitare, ndërhyrjet ushtarake (Helmetat e kaltra, NATO-ja etj.) dhe veprimet e shoqërisë civile (OJQ, si Amnesty International, KNKK si dhe shumë organizata të tjera), janë po ashtu të varura, në një mënyrë, nga përkthimet. Pa përkthyesit, Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën e ajo për ish-Jugosllavinë, nuk do të kishin mundur kurrë ta bënin punën e tyre. As Gjykata e Nurembergut më 1945.

1. Marianne Lederer et Fortunato Israël, Actes du colloque int. tenu à l'E.S.I.T., La liberté en traduction, Paris, Didier Erudition, 1990, p. 34

2. Ibid., p. 32

3. Jean-Claude Gémard, Traduire ou l'art d'interpréter, Québec, Presses universitaires de Québec, 1995, p. 15

Këto struktura kanë një pikë të përbashkët: ato veprojnë në terren dhe vep-
rimet e tyre gjuhësore, në shumicën e rasteve, më shumë ngjasojnë në një
përkthim të zbatuar, sesa në përkthimet e lidhura me hulumtime thelbësore,
si studimet e përkthimologjisë. Përkthimet letrare, gjatë shekujve, kanë
mundësuar «udhëtimin» e njerëzve, që nuk mund të lëviznin aq lehtë, sikurse
sot. Meqë letërsia tanimë e ka humbur monopolin e udhëtimeve imagjinare,
përkthimet e rendit teknik ose të specializuar, janë ato që e pararendin sot
skenën ndërkombëtare kundrejt shekujve letrarë.

Mirëpo, kemi arritur në një pikë, ku shija e zbulimit të tjetrit tashmë është
e çshenjtëruar. Do të kemi gjithnjë e më shumë persona, të shpresojmë, që
do të kërkojnë t'i njohin më mirë shtetet që kanë vizituar, vendet që kanë
zbuluar, për të kërkuar një thellim kulturor. Ata do t'i kthehen drejtpërdrejt
letërsisë ose përkthimit letrar, për t'i gjetur mendimet dhe për t'i dhënë kup-
tim kulturës së tyre. Për më tepër, siç e thoshte Ernest Renan: «Një vepër e
papërkthyer është vetëm një gjysmëbotim»⁽¹⁾.

Hana Arendt e ka saktësuar shumë mirë nevojën e tjetërisë, kur ka shkruar:
«Prania e tjetrit, që sheh atë që shohim dhe që dëgjon atë që dëgjojmë, na
siguron realitetin e botës dhe të vetes sonë»⁽²⁾.

«Bota ndërton tepër mure dhe pak ura», thoshte Isaac Newton në kohën e
tij. Përkthimi, kur nuk mund të ndërtojë ura, lundron ide, si anijet, nga një
breg në tjetrin. Sepse, «përkthimi në çdo kohë ka qenë një nga mekanizmat
thelbësorë të këmbimeve ndërkulturore»⁽³⁾.

Përmes përkthimit, komunikimi është për të gjithë popujt e botës ajo që janë
dendritet dhe aksiomat për trurin njerëzor: një komunikim për ta bërë një
mendim. Një neuron i izoluar nuk e bën një mendim të ndërtuar, ashtu siç
nuk çelë pranvera me një lule.

1. Jean-Claude Margot, Traduire sans trahir, Lausanne, L'Age d'Homme, 1990, p. 13.

2. Iso Camartin, De la cohabitation des langues, Genève, Editions Zoé, 1999, p. 14.

3. Jean-Louis Cordonnier, Traduction et culture, Paris, Hatier&Didier, 1995, p. 9.

3.5 Roli i përkthimit në komunikim në Evropë

«Edhe po të ishte bota një labirint, nuk do të mund ta kalonim pa i respektuar disa udhë të detyrueshme»

Umberto Eco

Evropa ndërtohet sot me hapa të mëdhenj? Pas Evropës politike dhe sidomos asaj ekonomike, tani është radha të ndërtohet Evropa kulturore. Evropa kulturore dhe ekonomike nuk do të mund të komunikonte pa përkthimet. Ajo kërkon më shumë përkthime dhe reflektime përreth mendimeve të ndryshme që mundësojnë të kuptohen më mirë kulturat e ndryshme që banojnë Evropën, qofshin ato të shumicës, qofshin të pakicës.

Mbase, Bashkimi Evropian sapo ka filluar një program të gjerë për përkthime letrare, me qëllim të forcimit të komunikimeve transnacionale⁽¹⁾.

Organizata të tjera në Evropë, si Këshilli i Evropës ose Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE), përkthimin e shoh si një arsye e e të qenurit dhe të veprimit. Mediet audiovizuale, si «Euronews» (tani në 13 gjuhë: gjermanisht, anglisht, arabisht, spanjisht, frëngjisht, portugalisht, rusisht...) dhe «Arte» (dygjuhësh gjermano-frënge), kartat bankare dhe monedhat, por edhe këmbimet artistike (për të përmendur këtu vetëm EUROSONG-un të njohur edhe si EUROVISION), janë të tilla falë përkthimit.

Programe këmbimesh gjuhësore dhe universitare, si Erasmus-Socrates (*European Region Action Scheme for the Mobility of University Students*) ose ECTS (Sistemi Evropian i Bartjes dhe Grumbullimit të Kredive) janë të varura nga një rrjet i tërë përkthimesh.

Po, «Përkthimi, veprimtaria përkthyesë, përjeton sot periudhën e saj të artë. Në agimin e një Evrope pa kufij, ajo luan, dhe do të luajë edhe më shumë nesër, një rol vendimtar në këtë rrjet shumë të madh të komunikimit, që do të jetë njësia evropiane»⁽²⁾. Z. Jean-Pierre van Deth, madje edhe thoshte «që, nëse përkthimi nuk njihet më shumë, në çdo pikëpamje, si një profesion, Evropa e vitit 1993 do të shkojë drejt dështimit dhe kaosit»⁽³⁾. Evropa, aq e larmishme nga rajonet gjuhësore dhe kulturore, po bën hapa të mëdhenj në komunikim dhe në njohjen e identiteteve gjuhësore dhe kulturore. Një strukturë përtej-kombëtare nuk ka pasur kurrë më parë rëndësi të tillë në komunikimin ndërgjuhësor.

1. http://ec.europa.eu/culture/our-programmes-and-actions/doc509_fr.htm

2. La traduction littéraire scientifique et technique, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, en couverture

3. Ibid., p. 6

Në këtë kontekst, «mbrojtja e shumëgjuhësisë është fjala kyçe e kësaj qasjeje»⁽¹⁾. Mbrojtja e shumëgjuhësisë është po ashtu sinonim i respektit të larushive të tjera, si larushia politike, ndjeshmëritë fetare ose përkatësitë etnike.

Rrënjët e mendimeve mbi përkthimet janë të thella në Evropë, që me Cicero-nin, në vitin 46 para Jezu Krishtit, i cili «përkthen për të bartur tek romakët elokucencë antike, modele përsosmërie. Nga ky përkthim do të lindë eseja e parë e mendimit mbi përkthimin»⁽²⁾. Sot, ne kuptojmë apo rikuptojmë këto mendime të thella, për t'i zhvilluar rreth përkthimit, në atë mënyrë që ato të mund të përsosen më shumë.

«Përkthimet e bëra nga romakët datojnë nga shekulli III para Jezu Krishtit, me Livius Andronicus, përkthyesi i parë i njohur evropian»⁽³⁾. Fakti që e rikuptojmë ende sot Livius Andronicus-in, është një mënyrë për t'ia dhënë atij vendin meritore që ka përkthimi në historinë e njerëzimit. «Vlen të dallojmë me kujdes, për çështjen që na intereson, Romën pagane nga Roma e krishterë. Të rikujtohet se përkthimi në Romën pagane ka qenë njëherësh një akt pedagogjik»⁽⁴⁾.

Përkthimi në Evropë sot njëkohësisht është një akt pagan, pedagogjik dhe fetar, por para së gjithash një akt kulturor, social dhe gjuhësor, që ka për qëllim të kultivojë hapësirat e kuptimit dhe njohurive të evropianëve të të gjitha horizonteve, besimeve, gjuhëve dhe rajoneve.

«Roma nuk është ndërtuar për një natë», thotë një fjalë e urtë. Nuk është gjithashtu vonë përreth disa vendimeve politike të vonshme që Evropa njohu rëndësinë e saj të këmbimeve dhe të respektit të gjuhëve; do të thosha madje edhe një respekt sociogjuhësor, sepse prapa gjuhëve ka një kontekst social, një shoqëri që flet një apo më shumë gjuhë. Të përkthesh, është një akt social.

Duke e vendosur «barazinë e gjuhëve zyrtare të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian më 1958», Këshilli i Evropës ka marrë një vendim të matur, sepse «shumëgjuhësia është element themelor i ndërtimit komunitar. Ai e garanton respektin e larmisë kulturore dhe të shumësisë gjuhësore. Përkthimi është aty në zemër të këtij mekanizmi, si një faktor këmbimi dhe bisedimi në respektin e ndërsjellë dhe jo si një makinë bluese identitetesh dhe dallimesh»⁽⁵⁾.

1. Évelyne Rosen, Le cadre européen commun de référence pour les langues, CLE International, 2007, p. /139

2. Michel Ballard, Europe et traduction, Ottawa, Les Presses de l'Université d'Ottawa, 1998, pp. 13-14

3. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, Que sais-je ? - PUF, 2003, pp 28-29

4. Michel Ballard, Europe et traduction, Ottawa, Les Presses de l'Université d'Ottawa, 1998, pp. 13-14

5. Michel Ballard, Europe et traduction, Ottawa, Les Presses de l'Université d'Ottawa, 1998, pp. 22

3.6 Roli i përkthimit në komunikim në Zvicër

*«Ajo që njerëzit këmbëjnë në komunikim,
nuk është gjuha, por mesazhet.»
Maurice Pergnier*

Ç'do të ishte Zvicra pa postë, CFF, Migros dhe Coop, pa doganat, kartëmonedhat, mediet, organizatat e Konfederatës dhe katër gjuhët e saj, të ndara ose dygjuhëshe si Biel-Bienne, Murten-Morat dhe Fribourg-Freiburg ... e më në fund, ç'do të ishte Zvicra pa katër gjuhët e saj, si dhe kohezioni kombëtar pa përkthimin?

Ç'do të ishte Zvicra pa etiketat ushqimore, barnat, udhëzimet e përdorimit ose fushatat reklamuese në katër gjuhët? Zvicëria gjuhësore më ka mahnitur ka kohë.

Po, gjermanofolësit janë shumicë dhe në kuvend gjuha gjermane është dominuese, ndërsa banorët e Teçinos dhe romanshët përbëjnë vetëm 10% të popullatës, por zotërojnë 50% të hapësirave në kartëmonedhat, megjithatë romanshët nuk përpiqen të thonë «danke», përderisa gjermanofolësit nuk ngurrojnë të thonë «merci» në çdo rast. Mirëpo, cili është shteti tjetër në botë që mund të mburret se ka nderuar aq shumë të gjithë përbërësit e tij gjuhësor? Nuk njoh shumë prej tyre.

A ka gjëra që mund të përmirësohen? Sigurisht se po, por bazat dhe themelet janë të fuqishme. Zvicëriani mesatar nuk turpërohet t'i lexojë raportet e Konfederatës dhe buxhetet e akorduara për mediet publike në rajonet minoritare.

Duke u kujdesur që të ruajnë një kohezion të tillë kombëtar ose qytetar, të zgjedhurit politikë mbështesin nganjëherë «procesin e hapjes dhe integritetit» në nivel kombëtar, ku përkthimi bëhet atëherë edhe mjet për ta shfaqur një identitet shumëgjuhësh dhe dallimin karshi së jashtmes»⁽¹⁾. Por, jo në pikën për ta mohuar tjetrin, por më shumë për ta respektuar tjetrin në vendin e tij. Periudha e mëdyshjeve duket e tejkaluar, ajo kur «megjithatë, përkthimet e fillimshkullit privilegjonin aspektin zviceran të veprave origjinale në dëm të hulumtimit të njëfarë cilësie letrare»⁽²⁾.

Jemi tashmë në faqen tjetër për të shkruar kapituj të tjerë. I pari, «Simpoziumi Zviceran për Përkthyesit Letrarë», i organizuar për herë të parë në Zvicër nga AdS (Shoqata e Autorëve Zviceranë) më 18 shtator 2009 në Bellinzone, shënon një periudhë të re të mendimeve mbi përkthimet.

1. Alena Vacek, *Approche historique de la traduction littéraire en Suisse*, Lausanne, CTL, 1995, p. 69

2. Ibid.

Zvicra e sotme dëshiron të kuptojë dhe të komunikojë jo vetëm me banorët që flasin të katër gjuhët «kombëtare», por edhe me të gjithë «banorët shqiptarë» të tjerë të Zvicrës. Vetëm në vitin «2008, rreth 120'000 orë interpretimi në komunitete janë regjistruar në Zvicër»⁽¹⁾.

Mbeten shumë probleme për t'u rregulluar, por aftësimet profesionale, të krijuara, ndër të tjera, edhe për përkthime në komunitete, tregojnë vërtet një interes dhe një angazhim, sigurisht. Para çdo risie, ngurrimet luajnë mikun besnik. «Disa mjekë nganjëherë janë të heshtur dhe druajnë nga prania penguese e një personi të tretë në marrëdhënien terapeutike, shpjegon Isabelle Fierro, përgjegjëse e shërbimit të interpretimit të shoqatës 'Appartenances'. Por, pasi që janë njohur me këtë përvojë, të shumtë janë ata që nuk munden pa përkthyesit...»⁽²⁾

Megjithatë, kur Fondi Kombëtar Zviceran i Hulumtimit Shkencor (FNS) e këshillon administratën publike në Zvicër «të sigurojë barazinë e shanseve të përfshira në ligjin e ri për të huajt, administrata publike duhet të mësohet të komunikojë më mirë me qytetarët jozviceranë»; gazeta e Kantonit të Vaud-it *La Nation* shtron ironikisht pyetjen vijuese: «Si është e mundur që asnjë hulumtues nuk e ka diagnostikuar ende nevojën që zyrtarët tanë ta flasin rrjedhshëm shqipen?»⁽³⁾

Zvicra, shteti i respektit të gjuhëve, shtet edhe i inovacioneve, sepse pas pasurisë së arit të bardhë (Alpet) dhe të kaltër (Kështjella e ujit) dhe të trurit, që paraqet krenarinë e tij (aftësimet e shkëlqyera), kjo Zvicër ka njohur lindjen, para pak kohësh, të një aftësimi të specializuar në Art-terapi, në komunën e Pully, në të njëjtin kanton me redaksinë e *La Nation*. Po sikurse redaksia *La Nation* të ndiqte kurse aftësimi në Art-terapi?

1. Aurélie Déspons, «Des interprètes pour ouvrir l'accès aux soins», Lausanne, Uniscope, UNIL, 24 mai 2010.

2. Ibid., p.

3. La Nation, Rubrique : «Le Coin du Ronchon», 27 février 2009, p. 2.

Kapitulli 4

**PËRKTHIMI NË NDËRTIMIN
E KOSOVËS SË «RE»**

4.1 Disa përkujtues që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe

«Gjuha shërben jo vetëm për të komunikuar, por edhe për të fshehur.»

Urszula Damska-Prokop

Gjuha shqipe njihet pak në Zvicër (mbase si gjetiu). Megjithatë, disa shkrimtarë shqiptarë kanë arritur ta zënë vendin e tyre në libraritë dhe në bibliotekat ku qarkullojnë lexuesit joshqiptarë, për ta përmendur vetëm Ismail Kadarenë. Duke qenë i ndaluar nën Perandorinë Osmane, të folurit shqip ka njohur rilindjen e vet jashtë territoreve gjeografike në Ballkan. Rilindja kulturore letrare ka ndodhur sidomos në Sicili dhe në Kalabri (Itali të jugut). Alfabeti i tanishëm shqip është krijuar vetëm më 1908 në Manastir, në Maqedoni të sotme. Njësimi i gjuhës letrare shqipe është bërë në Tiranë, në «Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe», më 1972.

Shqipja sot është një gjuhë që po ndryshon, e një debat i pasur shpie në standardizimin e shqipes. Gjuha shqipe është zhvilluar në një kontekst ku liria për të shkruar në gjuhën shqipe ishte pjesërisht e siguar, por jo ajo e shprehjes së mendimeve. Prej këtui edhe zhvillimi i letërsisë, mjeti i vetëm për një popullatë që të shprehet në të gjitha mënyrat dhe më shpesh midis rreshtave. Një letërsi përfytyruese, e pashuar dhe metaforike, që është e kombinuar njëkohësisht me shijen e muzikës dhe të këngës. Por, këto bukuri të shprehjes artistike nganjëherë kanë vështirësi për të komunikuar shprehimisht me tjetrin, sepse shpeshherë janë shumë të vetëkuptueshme për shkak të censurës, pa e harruar vetëcensurën, që ka shoqëruar shumë autorë përgjatë viteve.

Shembulli i Kosovës e përfaqëson mirë këtë hulumtim kualitativ për disa arsye, sepse është një shtet i ri, në ndërtim e sipër, dhe pastaj sepse është një rajon që është mbajtur për gjatë kohë anash botës politike, ekonomike, kulturore, turistike dhe sportive, e njëkohësisht gjithnjë në kërkim të kontakteve dhe të komunikimit, sidomos përmes përkthyesve.

Popullata kosovare, 90% shqipfolëse, në sytë e mi, për nga pozita dhe për nga historia e saj, paraqet një «laborator të gjallë ndërkulturor» të vërtetë, për ta studiuar temën e «përkthimeve dhe komunikimeve ndërkulturore». Duket madje që edhe televizioni publik kosovar (RTK) është ndër të vetmit transmetuesit publik në Evropë, që çdo ditë transmeton emisione të ndryshme në pesë gjuhë, në të njëjtat frekuenca: në shqip, boshnjakisht, në gjuhën rome, në turqisht dhe në serbisht. Gjuha shqipe flitet në disa shtete: në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni (rreth 40%), në Serbinë e jugut (Lugina e Preshevës) dhe në Mal të zi (në zonat e Ulqinit, Plavës dhe Gucisë).

Ka edhe gjuhë të tjera që fliten në disa shtete, si gjermanishtja (Gjermani, Asutri, Luksemburg dhe Zvicër), frëngjishtja (Francë, Belgjikë, Zvicër, Luksemburg, Kebek dhe disa shtete të Afrikës), spanjishtja (Spanjë, Amerikë latine, por edhe në New-York, Floridë dhe Kaliforni), anglishtja (SHBA, Kanada, Angli, Australi dhe shumë shtete të tjera, si: Danimarka dhe Suedia), ose turqishtja (në Turqi dhe në ish-territoret e Perandorisë Osmane) etj.

Gjuha shqipe është pranuar vonë në Kosovë dhe Universiteti publik i Prishtinës është themeluar vetëm më 1970. Gjatë pushtimeve të Ballkanit nga Perandoria Osmane, shqiptarëve u është ndaluar e drejta e përdorimit publik të gjuhës së tyre, përderisa popujt e tjerë ballkanikë e gëzonin këtë të drejtë.

Gjuha shqipe në disa rreshta:

-Gjuha shqipe është pjesë e gjuhëve indoevropiane.

-Në trungun e këtyre gjuhëve, gjuha shqipe është një degë e veçantë

Gjuha shqipe është një degë e veçantë në trungun e këtyre gjuhëve (siç është gjuha greke dhe gjuha armene), por pa ndonjë ndërlidhje me këto dy gjuhë dhe nuk është pjesë e asnjë familjeje të madhe gjuhësore (gjuhët latine, gjermanike, sllave, perse etj.).

- Janë dy dialekte kryesore: gegë dhe toskë.

- Alfabeti është latin. Ka 36 shkronja. Shkrimi fonetik. Të gjitha shkronjat shqiptohen.

- Gjinitë janë: mashkullore, femërore dhe asnjane.

- Gjuha shqipe, pos lakimeve, ka edhe nyja e ato janë: i, e, të, së dhe përdoren tek emri, mbiemri, numërori dhe përemri

Mendohet se gjuha shqipe rrjedh nga ilirishtja, «të atyre Ilirëve, që e kanë pushtuar Ballkanin në antikitet, por që, ndryshe nga grekët ose latinët, nuk na e kanë lënë asnjë dëshmi të drejtpërdrejtë për gjuhën e tyre. Vetëm arkeologjia – të nxitur aktivisht në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore – fillon t'i nxjerrë nga terri», thotë Dominique Briquel, profesor në Universitetin e Paris-Sorbonne ⁽¹⁾.

Sipas Matthieu Aref⁽²⁾, «shqipja, që rrjedh nga pellazgishtja e lashtë, është një «rast i vetëm në Evropë, ku një popull i vetëm jeton në tokat e tij të lashta që nga koha e neolitit, ose edhe më herët. Ndërkaq, pellazgo-etruskët janë me prejardhje të dy qytetërimeve të famshme perëndimore: greke (përmes pellazgëve) dhe romake (përmes etruskëve).

Shqipja është një fosil vërtet i gjallë.»

1. Mathieu Aref, Albanie ou l'incroyable odyssée d'un peuple préhellénique, Paris, Mnémosyne, 2003, p.3

2. Ibid., p. 320

Këto pohime kanë konotacione romantike, por, siç e nënvizion Dominique Briquel, «vetëm mund të ngazëllohem i një dokumentacion është tashmë i dhënë dhe i përfshirë në debatin shkencor».

Lidhur me këtë, përkthimi është një nga boshtet e kuptimit midis njerëzve, por edhe midis gjuhëve. Gjuha merr kuptim në përkthimin. «Gjuha e faraonëve ishte ndoshta po aq e pakuptueshme sa ajo e etruskëve. Një gjuhë që nuk mund të përkthehet tutje, është një gjuhë e vdekur, para se përkthimi ta ringjallë atë»⁽¹⁾.

Gjuha shqipe e Kosovës është studiuar shumë pak nga fqinjët e saj. Studimet e vetme në të kaluarën burojnë nga hulumtuesit italianë, gjermanë, rumunë ose edhe hulumtuesit e tjerë, si Lahovary, gjuhëtar spanjoll, që, pos të tjerash, shkruan: «Me gjithë izolimin me të cilin e kishin dënuar bjeshkët e vrazhda dhe brigjet e rrezikshme të Shqipërisë, shqipja ka mundur ta ruajë një leksik të pasur të dëshmive të gjuhës paraindoevropiane të Ballkanit. Ne do të shohim, me shembuj, që janë larg së shpenzuari materialin, që kjo gjuhë (ose dialektet e saj) ishin mjaft të afërta me gjuhën baske»⁽²⁾.

Sot, përderisa Kosova ka tejkaluar një faqe të rëndësishme të historisë së saj, sidomos pas luftës së vitit 1999, komunikimet e saj janë më shumë se kurrë të nevojshme për ta fituar kohën e humbur, por edhe për ta rizbuluar të kaluarën e saj, për ta ndërtuar më mirë të ardhmen e saj.

Përkthimologjia është leva e kësaj sfide të madhe të komunikimit me të tjerët, njëherësh me fqinjët e saj, por edhe me vetë shtetin dhe banorët e saj.

1. Michaël Oustinoff, *La Traduction*, Paris, Que Aais-je ? - PUF, 2003, p.11

2. N. Lahovary, *Le basque et les éléments pré-indo-européen de l'albanais*, San Sebastian, 1958, pp. 9-10

4.2 Komunikimi në Kosovë dhe përkthimet

*Komunikimi është një vepër që nuk improvizohet,
ose atëherë duhet vepruar për ta improvizuar.*

Kur përmendim temën e komunikimit në Kosovë dhe atë të përkthimit, që është e ndërlidhur, shtrohet pyetja se për çfarë përkthimi bëhet fjalë, ose nga cila gjuhë në cilën gjuhë?

Shumica e popullatës në Kosovë flet shqip (më shumë se 90% e popullatës). Deri më 1999, administrata në Kosovë ishte e drejtuar nga pakica serbe, me mbështetjen e pushtetit qendror të Beogradit (kryeqytet i Serbisë). Për këtë arsye, gjuha serbe ishte e gjithëpranishme. Si shembull, kinematë në Prishtinë, banuar me shumicë nga një popullatë shqipfolëse, shfaqnin filma me titra vetëm në gjuhën serbe.

Megjithatë, në vitet '70 të shekullit XX, sidomos pas hapjes së Universitetit të Prishtinës (1970) dhe me autonominë e zgjeruar të Kosovës (Kushtetuta e vitit 1974), përparime të mëdha janë bërë sa i përket përdorimit të gjuhës shqipe në Kosovë. Për më tepër, komunikimi që ishte rritur me Shqipërinë gjatë viteve '70 i dha një shtytje letërsisë dhe përkthimeve në Kosovë.

Protestat e përgjakshme në vitet '80 në Kosovë, heqja e autonomisë nga pushteti i Beogradit, mbyllja e institucioneve akademike, luftërat në ish-Jugosllavi gjatë viteve '90 (e ndërhyrja e forcave perëndimore në mars 1999), patën një ndikim rrënues mbi një vrull drejt përparimit që shfaqej në horizont në këtë vend.

Pas ndërhyrjes së NATO-s, Shtetet e Bashkuara vendosën një administratë të re përmes UNMIK-ut (Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë).

Që nga vendosja e tij, UNMIK-u ka angazhuar sidomos të rinjtë. Këta të rinj kishin një bagazh gjuhësor, por më pak sociogjuhësor për gjuhën për të cilën ishin të punësuar, veçanërisht për anglishten.

Ata ishin punësuar sidomos për të kryer përkthime gojore në terren (për ushtarët, policinë e UNMIK-ut, punën e OJQ-ve në vend, si dhe për shërbime të ndryshme të pranishme në terren). Paga mesatare për punën e përkthyesit e tejkalonte së paku tri herë atë të motrës sime juriste dhe të motrës tjetër mjeke.

Më vonë, nevoja për të përkthyer dokumente me shkrim (sidomos ato të ligjvënies dhe drejtësisë) ishte e nevojshme, si për të komunikuar me «ndërkombëtarët» e pranishëm në vend, ashtu edhe për komunikimin e banorëve midis tyre, sidomos me personat që flasin serbokroatisht dhe shqip.

4.3 Përkthimi, një sfidë për administratën e re

Që nga viti 1999, ndihen tmerrësisht një mori nevojash lidhur me përkthimin: në administratë, në dokumente zyrtare, në udhëzues, në produkte shtëpiake dhe teknike, në njoftimet e paketimeve për ushqimin dhe në produktet farmaceutike, në audiovizualen (përfshirë në filma dhe në seriale televizive) dhe në tekste shkencore e letrare.

Legjislacioni për përdorimin e gjuhëve në vend është më i përparuar, sepse pakica serbe, që përfaqëson rreth 6% të popullatës, gëzon një status gjuhësor të barabartë me gjuhën shqipe: në administratë, në rrugët dhe në fshatrat e Kosovës, shkrimet janë në gjuhën shqipe dhe serbe, edhe në komunat ku nuk banon asnjë serb. Neni 2:2.3 mbi përdorimin e gjuhëve nënvizon si vijon: «Në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe që përbën së paku 5% të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do ta ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do të ketë statusin e barabartë me gjuhët zyrtare»⁽¹⁾. Në komunën e Prizrenit, përveç shqipes dhe serbishtes, turqishtja është gjithashtu gjuhë zyrtare. Për shembull, 20 vende janë të rezervuara në kuvend (për gjithsej 120 vende) për pakicat, përderisa popullata e pakicave nuk e tejkalon 10%. Kjo situatë ilustron një vullnet të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe të klasës politike në vend për të treguar se Kosova nuk është shoqëri njëetnike, por një shtet i përbërë nga një dallueshmëri e madhe banorësh, pavarësisht nga gjuha e tyre ose prejardhja e tyre etnike. Pas luftës dhe tensioneve dhjetëvjeçare, ekziston mosbesimi, hezitimet janë ende të pranishme, kundërtëhëniet ende shprehen, por disa hapa janë bërë; megjithatë, të gjithë e dinë se një rrugë e tërë mbetet për t'u bërë, si në komunikimin midis bashkësive, ashtu edhe midis kosovarëve dhe kulturave e gjuhëve të tjera.

1. Journal officiel des Institutions provisoires d'autogestion au Kosovo / Pristina ; II, No. 10, 1er MARS 2007, p.11.

Në mesin e nevojave të përkthimeve, të ndiera menjëherë, çështjet praktike janë më të rëndësishmet:

- Njoftimet e paketimeve për produktet farmaceutike. Në fakt, edhe pse korniza juridike i detyron personat dhe njësitë e interesuara t'i blejnë ilaçet në barnatore, pothuajse të gjithë artikujt kanë shënime që nuk janë në gjuhën shqipe. Si rrjedhojë, një pjesë e madhe e popullatës përdor këto produkte, pa e pasur informatën e vetme mbi mënyrën e përdorimit të tyre, e aq më keq: për efektet e tyre. Mendohet se kostot e përkthimeve dhe produkteve janë arsyet kryesore të kësaj gjendjeje. Mund të blini antibiotikë dhe anksiolitikë, si bonbone. Por duket se kjo gjendje po përmirësohet.

- Përbërësit që hyjnë në ushqim. Mungesa e përkthimit është problematike, sepse qytetarët vazhdojnë të konsumojnë ushqime, për të cilat vetëm mund të imagjinojnë përbërjen e tyre. Jam gjendur para situatave ku shitësit nuk ishin në gjendje të më tregonin nëse produktet e caktuara kishin sheqer dhe nëse ishin në përputhje me përdorimin e tyre për diabetikët.

«Nuk jemi barnatore», iu përgjigj një shitëse klientes në një dyqan ushqimor, me sa duket e acaruar nga pyetjet e klientes: «Pse nuk i përktheni përbërësit e këtij produkti?» Përveç këtyre nevojave, ndihet një nevojë tjetër gjithashtu: përkthimet e teksteve shkencore.

Studentët dhe profesorët vazhdojnë të përdorin ose përkthime të vjetra (pjesa më e madhe e këtyre si ripërkthime nga serbokroatishtja), ose përkthime që janë nga Shqipëria, ose tekste origjinale nga anglishtja.

4.4 Komunikimi në kushte të «izolimit»

Brezi i studentëve të viteve '70 dhe '80 përdorte drejtpërdrejt vepra në serbokroatisht. Brezi i pasluftës nuk kishte ndonjë bagazh gjuhësor, që të mund të përdorte veprat në serbokroatisht. Prindërit e tyre i kanë kryer shërbimet e tyre ushtarake, ku duhej të shpreheshin në serbokroatisht. Ata ballafaqoheshin me një administratë serbokroate, ndiqnin mediet në serbokroatisht dhe e kishin kryer shkollimin, ku serbokroatishtja mësohej nga shkolla fillore. Prej nga edhe një brez i tërë përkthyesish serbokroatë, që ishin plakur, ndryshe nga ata që përkthenin në gjuhët e tjera (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht etj.), ku shumica ishin të rinj.

Përkthimi i teksteve letrare mbetet problemi kryesor. Edhe pse nuk i prek njerëzit në jetën e tyre të përditshme, megjithatë kjo është një mangësi që mund të mungojë shumë në afat të gjatë.

Përkthimet letrare vinin dhe vazhdojnë të vijnë nga Shqipëria, e izoluar gjatë dhjetëra vjetëve, e ku përkthyesi ose përkthyesja ishin vënë në një pedestal. Jusuf Vrioni, përkthyesi i Ismail Kadaresë, është ende vetë referenca e përkthyesit, i cili e ka pasur një rol qendror në komunikimin e shkruar midis shqipes dhe frëngjishtes.

Izolimi i Shqipërisë dhe i popullatës shqiptare të ish-Jugosllavisë e shpjegon rëndësinë pa precedent që shqiptarët ua kanë njohur përkthyesve. «Gjatë dhjetëra vjetëve, ata e kanë parë veten si figura mistike dhe nganjëherë edhe më të rëndësishme sesa vetë shkrimtarët. [...] Kësisoj, gjatë tërë këtij izolimi kulturor, puna e përkthyesit, më shumë se një profesion, është transformuar më shpesh në një mision», shkruan Ledi Shamku-Shkreli⁽¹⁾.

«Kur përkthej, por edhe kur shkruaj, punoj me të njëjtën ndjenjë. Kur përkthen, je edhe autor, ose një lloj autori i atij libri për popullin tënd», thotë Amik Kasoraho, përkthyes, që, në kuadër të punimeve të tij të shumta, ka përkthyer në italisht autorë shqiptarë, si: Fatos Kongoli, Azem Shkreli, Pirro Misho etj.⁽²⁾ Kjo është arsyeja, në një kontekst të tillë, që kjo shprehje merr tërë kuptimin e saj: «Nga kjo pikëpamje, shkrimi dhe përkthimi vihen saktësisht në të njëjtin rrafsh»⁽³⁾.

Por, përkthyesi kishte një detyrë të vështirë, sepse duhej jo vetëm të përkthente atë që kishte menduar autori, por edhe atë që mendonte regjimi. Shqipja bën pjesë në gjuhët e rralla, të panjohura, pa sfida politike kryesore, as ekonomike, as demografike. Për më tepër, kjo gjuhë ishte e ndaluar gjatë shekujve nga osmanlinjtë, pastaj e rrethuar, shekullin e kaluar, nga regjimet dhe nga shtetet që nuk kishin asnjë interes as për ta kuptuar, as për ta vënë në pah si një mjet komunikimi të ndërsjellë. Pak fqinj grekë, turq, serbë ose bullgarë e flasin shqipen, përderisa shumë shqiptarë shprehen ose mund të shprehen në këto gjuhë.

Sot, për arsye të interesave politiko-ekonomike, më shumë se për arsye bindjesh kulturore, qëndron ende mendimi i shprehur nga Lawrence Humphrey në «Interpretatio» e tij, të botuar më 1559 në Bazel, që «cilësia e një përkthimi varet pjesërisht nga natyra e gjuhëve ku janë të përfshira»;

1. Ledi Shamku-Shkreli, Misioni i përkthyesit në kulturën tonë postkomuniste (traduction : La Mission du traducteur dans notre culture post-communiste), 28 décembre 2009.

2. Vullnet Krasniqi, « Shkrimtari që përktheu jetën e vet », (L'écrivain qui traduisit sa vie », article paru dans le journal Koha Ditore, Prishtinë, 15 juin 2010.

3. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, - PUF, Que sais-je?, 2003, p.19

ai dallon kështu «gjuhët kryesore» dhe «gjuhët e vogla»; «përkthimi ka vlera vetëm midis gjuhëve kryesore, gjuhën hebraike, greke dhe latine»⁽¹⁾. Nëse cilësia nuk është ajo që diskutohet në ditët tona, ndryshe nga kjo, interesi po.

Përkthimi me gojë është një pasuri e jashtëzakonshme, sepse përkthimi me shkrim mungonte shumë; ai mund të gjente një vrull njohjeje nëpërmjet përkthimeve, sepse përkthimi mund të luajë një rol kryesor në dy fusha njëkohësisht. «Në njërën anë, duke u dhënë sërish prestigj vlerave kulturore tradicionale, ai e inkurajon bashkësinë gjuhësore drejt ruajtjes së trashëgimisë së saj. Madje, ai ia hap publikut evropian një trevë të re kulturore. Suksesi i traditës së Mahabharata, për shembull, tregon se sa është jetike që të kemi qasje të përfytyruar. Në një mënyrë, jemi të ftuar ta bëjmë rrugën në drejtim të kundërt dhe të marrim nga një trashëgimi dikur të harruar dhe sot në rrezik»⁽²⁾.

Vlerësimi i kriterit të «distancës kulturore» është rritur nga disa autorë; mund të lexohet në *La Traduction littéraire, scientifique et technique (Përkthimi letrar, shkencor dhe teknik)*. «A e kemi synim numrin e folësve autoktonë? Do të jetë gjuha inuite, çeke ose shqipe. Kemi të bëjmë me një gjuhë pak të studiuar në Francë? Gjuha kineze, ruse, madje edhe arabe, do të ishin pa dyshim pjesë të saj. Për të shmangur çdo dykuptimësi, do ta vëmë këtu në pah kriterin e «distancës kulturore», që e shpreh qartë natyrën e një problemi që mund të përmbliidhet kështu: sa më i madh është largimi gjuhësor dhe kulturor, aq më e vogël është aftësia e receptuesit për të kuptuar»⁽³⁾. Por, distanca kulturore e shqipes me fqinjët e saj të afërt është e tillë që një ndërtim i madh duhet të jetësohet për ta thjeshtuar atë për t'u kthyer bashkë drejt Evropës dhe botës demokratike.

Gjuhët e shkruara caktojnë mendimet, fjalët dhe mënyrat për t'u shprehur në letër. «Ndryshimet e përvojës njerëzore nuk ndeshen me automatizëm brenda gjuhës, gjë që shpjegon përse vazhdojmë të themi se dielli lind»⁽⁴⁾. Një autor shqiptar, pas refleksioneve të tij mbi pushtimet që vinin nga Lindja (osmanët, sllavët etj.), ka shkruar një ditë se edhe «Për ne shqiptarët, dielli lind nga perëndon». «Andaj, kjo tezë sugjeron që jo vetëm gjuha orienton dhe organizon vizionin tonë për botën, por edhe e imobilizon»⁽⁵⁾.

1. Michel Ballard, Europe et traduction, Ottawa, Presses de l'Université d'Ottawa, 1998, pp.17-18

2. La traduction littéraire scientifique et technique, Bruxelles, La Tilu éditeur, 1991, p.60

3. Ibid., p. 55

4. Georges Mounin, Les Problèmes théoriques de la traduction, Paris, Gallimard, 1963, p.273

5. Ibid., p. 253

Në këtë situatë, përkthimi luan një rol më se të rëndësishëm, sepse «në realitet, vizionet e botës dhe gjuhët nuk janë të palëvizshme, e përkthimi, as ai – si kontakt midis dy gjuhëve – nuk është një situatë gjuhësore e palëvizshme dhe e jashtëkohshme»⁽¹⁾.

4.5 Sfidat e reja të përkthimit në Kosovë

Përkthimi në gjuhën shqipe, aq i rëndësishëm, aq i domosdoshëm dhe aq i nevojshëm, përmban edhe pikëpyetje, që asnjë legjislacion nuk mund t'i zgjidhë:

- Mungesa e interesit politik, ekonomik dhe institucional.
- Një situatë jo e favorshme për shkak të ngjarjeve dhe situatës globale (prioritetet e tjera shqetësojnë banorët, si mbijetesa ekonomike, e kaluara e afërt me ngjarjet e saj tragjike të njëpasnjëshme).
- Mungesa e studimeve shkencore mbi përmbajtjen e përkthimeve, por edhe mbi formën ose teknikat e përkthimeve, e si pasojë mungesa e një aftësimi të veçantë për përkthyesit e ardhshëm.
- Sot, për strukturën e gjuhës shqipe nuk kemi një mendim të njëzëshëm (struktura gramatikore, morfologjia, fonologjia, sintaksa, leksiku, etimologjia...). Shumë gjuhëtarë dhe analistë kontestojnë kushtet në të cilat Shqipëria e viteve '50 ka njësuar gjuhën. Shumë folës ndihen të injoruar, sidomos ata të dialektit gegë (Veriu i Shqipërisë dhe Kosova). Një gjuhë e pastandardizuar ka të gjitha gjasat që të mos mund të përkthehet në një gjuhë tjetër, sepse mbi çfarë baze një përkthyes e bart mesazhin? Merreni me mend një kontratë ekonomike, një tekst juridik ose edhe një raport mjekësor, që e ka bërë një përkthyes dhe që e ka përdorur këtë apo atë dialekt, cilat do të ishin keqkuptimet? Zgjidhja do të mund të gjendej në rishikimin e fjalorit të tanishëm, duke e plotësuar atë, me tërë leksikun mungues. Lidhur me këtë, Mehmet Elezi sapo ka botuar një fjalor që pasuron mendjen. Një gjuhë e strukturuar është një garanci e integritetit të të gjitha dialekteve të saj, të regjistrave të saj kombëtar dhe lokal, të folësve të saj, e së fundi të gjithë jetës së saj gjuhësore. Dhe, siç e thotë Mathieu Guidère, «Në të tilla raste është e mundur të jetësohen kuptime identike në kuadër të këtyre zonave, pa pasur nevojë të përkthehen domosdoshmërisht, por vetëm duke e marrë regjistrin e gjuhës përgjegjëse ose edhe variantet rajonale dhe/ose lokale»⁽²⁾.

1. Georges Mounin, Les Problèmes théoriques de la traduction, Paris, Gallimard, 1963, p. 276

2. Mathieu Guidère, La Communication multilingue, Bruxelles, De Boeck Université, 2008, p.20

Mbase përkthimi do të mund të ndihmonte në strukturimin e një gjuhe. Ndoshta te përkthimi mund të jetë një pjesë e madhe e zgjidhjes, sipas Claudine Spitaels: «Një përkthim është gjithnjë «përbashkues», sepse synon t'i fshijë disa veçori të origjinalit. Përveç kuptimit dhe stilit, kjo prirje ka të bëjë me disa aspekte të vetë gjuhës». Studimi i Claudine Spitaels ka të bëjë me dallimet midis holandishtes së Flandrës dhe holandishtes së Holandës, që janë përgjithësisht të mënjanuara në përkthimin francez. Siç e tregon autori, «këto dallime nuk janë vetëm e vetëm leksikore, siç mund të mendojmë në fillim. Ato gjenden në një nivel më të thellë të gjuhës dhe reflektojnë dy mënyra të ndryshme për t'i shikuar gjërat dhe dy sjellje të ndryshme karshi gjuhës së njëjtë, holandishtes»⁽¹⁾.

Tash e rreth njëzet vjet, një numër i madh përkthimesh të veprave në gjuhë të ndryshme janë në shërbim të publikut shqipfolës. Kjo etje për të komunikuar nuk bëhet pa vështirësi, qoftë në përzgjedhjen e teksteve, qoftë në mënyrën e përkthimit ose të përzgjedhjes së përkthyesve.

Megjithatë, që disa kohë, disa shkrimtarë në gjuhën shqipe janë marrë me këto tema, para së gjithash: Edmond Tupja, por edhe Ledi Shamku-Shkreli, Mira Meksi, Nerimane Kamberi, Sazana Çapriqi e disa të tjerë.

Në të kaluarën, në Shqipëri, kishte një traditë të madhe të përkthimit letrar. Fan Noli, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi, Faik Konica, Ismail Kadare dhe Dritëro Agolli ishin edhe shkrimtarë, edhe përkthyes. Përzgjedhja e përkthimeve deri në vitet '90 bëhej me një lloj ndikimi ideologjik (përfjashtuar klasikët e mëdhenj). Një antologji letrare, «Tregime të shekullit të njëzetë» e viteve '70⁽²⁾, përmban tekste të 37 autorëve nga 17 shtete, duke trajtuar tema shumë të zymta: alkoolizmin, krizën ekonomike, sëmundjet etj. Po pra, duhej treguar se bota nuk ishte e shëndoshë dhe se shqiptarët nuk jetonin edhe aq keq... Ideologji e kulluar.

Në regjistrin e njëjtë, fundi i romanit të Thomas Hardy-t nuk është përkthyer, nën pretekstin se mund të ketë ndikim në rininë shqiptare»⁽³⁾.

Ndryshimet demokratike të viteve '90 në Shqipëri dhe në pasluftën e Kosovës dhe Maqedonisë, kanë nxitur një pjesë të madhe të botuesve të botojnë, shpesh me nxitim, vepra të huaja. Por jo pa vështirësi, sepse «viteve të fundit, te ne, shumë gjëra koti janë përkthyer. Jo vetëm e vuajti komunikimi kulturor, por edhe zhvillimi i gjuhës dhe i kulturës dhe bashkë me këto edhe edukimi i

1. L'interprétation du texte et la traduction, Louvain, édité par Sv. Vogeeler, BCILL, 1995, p. 7

2. Sh.B. Naim Rafshëri, Tregime të shekullit të njëzetë*, 10.000 exemplaires, Tiranë, 1977 (*Recits du 20ème siècle)

3. Sazana Çapriqi, «Përkthimi – detyrim apo zgjedhje» (La traduction – obligation ou choix), Zëri, Prishtina, 13.6. 2010

tërë një brezi shkrimtarësh shqiptarë», pohon Mira Meksi⁽¹⁾.

«Si të përkthehen anglisht, qoftë edhe tri ose katër fjalë që emërtojnë në rajonin e Aix më 1959, këtë apo atë bukë (baguette, flûte, couronne, fougasse, fusée etj.) (baget, e gjatë, me kuleç, me vaj ulliri, focaccio etj.) dhe për të cilin George Mounin jep një listë për t'u dridhur», shkruan D. Aury⁽²⁾.

«Atë ditë, e veshur me fund të zi dhe me bluzë të kuqe, ajo është arrestuar menjëherë nga policia civile...». Si të përkthehet ky tekst nga shqipja në frëngjisht dhe të bëhet i kuptueshëm? Nuk është me siguri fakti se policët nuk e donin Stendhalin dhe romanin e tij «E kuqja dhe e zeza», por vetëm se këto ngjyra e kujtonin flamurin shqiptar, të ndaluar nga policia.

Si të përkthehet kjo fjali pa konotacion politik?

Shumë më i komplikuar se poezia, loja me fjalë, teatri ose edhe diskursi politik, përkthimi i ndjenjave, të një individi ose të një populli të tërë, mbetet sfida më e madhe e të gjithë përkthyesve, por edhe një detyrë fisnike, sepse njohja e vuajtjes është ilaçi më i mirë dhe përkthimi, lajmëtari i tij. Një përkthyes, si shkrimtari, do të duhej të ishte i vetëdijshëm se ndjenjat e tij nuk mund të jenë medoemos të ndiera nga një publik në gjuhën e tij, në rajonin e tij, e as në vetë familjen e tij. Edhe më pak në një gjuhë të huaj. Kjo është edhe më e përshtatshme për një përkthyes, sepse «një tekst është shkruar në funksion të një publiku të dhënë. Kur ai përkthehet, ai bëhet i dekontekstualizuar, që do të thotë i ndarë nga mjedisi ku ka lindur dhe i drejtuar nga lexues të rinj, për të cilët nuk është hartuar fillimisht dhe nevoja e të cilëve gjithashtu duhet të merret parasysh».

Kosova duhet dhe dëshiron të komunikojë, sidomos me vetveten, me përbërësit e saj gjuhësorë dhe rajonale, pastaj me fqinjët e saj dhe së fundi edhe me botën, në paqe dhe qetësi.

Komunikimi është një vepër që nuk improvizohet ose atëherë duhet vepruar që të mund të improvizohet, duke fituar kulturë dhe duke e pasuruar kulturën e vet.

1. Mira Meksi, «Një kabanë për përkthimin letrar» (Une cloche pour la traduction littéraire), Express, 10.01.2010

2. Georges Mounin, Les Problèmes théoriques de la traduction, Paris, Gallimard, 1963, préface

3. Actes du colloque international tenu à l'E.S.I.T., La liberté en traduction, Paris, Didier Erudition, 1990, p.39

Kapitulli 5

**PËRFUNDIM: PROLOG
NË VEND TË EPILOGUT**

*«Përkthimi bashkon dy lloje gjuhësh, që njerëzimi mban brenda vetes:
Natyrën dhe Kulturën».*
Jean-Claude Gémard,

Në vend të përfundimit, do të doja të përmendja që i takoj brezit i cili ka njohur luftën e ftohtë, tranzicionin pluralist dhe rrymat e reja të komunikimit midis ndërkombëtarëve dhe ballkanasve, në përgjithësi, e kosovarëve, në veçanti.

Nëse disa autorë vlerësojnë se Kanadaja, Zvicra ose Belgjika janë «laboratorë të vërtetë gjuhësor», Kosova duket të jetë gjithashtu një laborator i tillë. Me të vërtetë, veçanërisht eksperimentale. Në këtë kontekst, duket e rëndësishme të citoj Paul de Man: «Veprimtaria e përkthimit është e pandashme nga nocioni i përparimit. Pretendohet madje se një shoqëri vlen aq sa i pranon përkthyesit. Kjo tregon rëndësinë e veprës së përkthyesve»⁽¹⁾.

«Më lexo atëherë, me durim, e nëse të acaroj, mos ia hedh fajin përkthimit, por atij që e ka shkruar tekstin i pari», i thotë një mikut Edmond Tupja⁽²⁾. Përkthimi nuk do të duhej të vihej në dyshim nga një përdorim i gabuar. Vërejtjet që pretendojnë se përkthimet bëhen në mënyrë të njëanshme, nuk bëhen vetëm në Kosovë. Mungesën e reciprocitetit e gjejmë diku tjetër: «[...] Përkthimi përfaqëson vetëm se 2% të veprave të botuara në Shtetet e Bashkuara ose në Britani të Madhe, përderisa përfaqësojnë 8 deri në 12% në Francë, rreth 14% në Gjermani dhe deri në 25% në Itali. Megjithatë, anglishtja është gjuha më e përkthyer në botë, që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Mosbaraspesha duket sheshit», përfundon Michaël Oustinoff⁽³⁾. Mirëpo një shoqëri, si shoqëria kosovare, e cila ka vuajtur nga mungesa e komunikimit, thellësisht e ndien mungesën e reciprocitetit në përkthime dhe në komunikim, sepse, fundja, vetë fjala komunikim nënkupton «të bashkojmë» dhe kjo ndarje bëhet në të dy anët e jo njëanshëm. Me të vërtetë, çiftit të pandashëm përkthim-komunikim, do t'i mungojë vetë qenia e ekzistencës së tij.

«Përkthyesit, si sajues të alfabeve, ndërtues të gjuhëve kombëtare, zejtarë të letërsive kombëtare, përhapës të njohurive, aktorë të skenës së pushtetit, përhapës të religjioneve, importues të vlerave kulturore, hartues

1. Paul de Man, *Autour de la tâche du traducteur*, Paris, TH.TY, , 2003, p.14

2. Edmond Tupja, *Conseils au nouveau traducteur*, Tirana, Onufri, 2000, p.7

3. Michaël Oustinoff, *La Traduction*, Paris, PUF, *Que sais-je ?*, 2003, p.47

të fjalorëve ose dëshmitarë të privilegjuar të historisë»⁽¹⁾, kanë një rol të madh për të luajtur në skenën ndërkombëtare. Por nuk janë të vetmit. Në këtë skenë janë regjisorët, producentët, grimerët, teknikët dhe sidomos, përreth tyre, publiku. Nuk duhet të lihen vetëm në skutën e tyre.

Gide ka shkruar: «Njëherësh, kërkoja që përkthimet e veprave të mia të më dërgoheshin, dhe kjo më dukej më e mira që ishte më e përafërt me tekstin në frëngjisht. E kam pranuar shpejt gabimin tim dhe tash u kërkoj përkthyesve të mi, që të mos e shohin veten rob të fjalëve të mia, të fjalisë sime, të mos merren tepër me punën e tyre... Por, edhe një herë, kjo këshillë është e mirë vetëm nëse përkthyesi njeh për mrekulli burimet e gjuhës së tij dhe nëse është i aftë të futet në mendjen dhe në sensibilitetin e autorit që merr ta përkthejë, derisa të identifikohet me të»⁽²⁾. Po, përkthyesi futet në shpirtin e shkrimtarit, si çdo aktor i mirë te personazhet e tij. Po, «përkthyesit nuk janë vetëm se hije»⁽³⁾. Po, përkthyesi ka në vete «vullnetin e rigorozitetit dhe zgjedhjen a priori të modestisë së atij që dëshiron më pak të shndrisë sesa të ndriçojë»⁽⁴⁾.

Nocioni i besnikërisë shpeshherë është vënë në pah, kur është përmendur çështja e përkthimit. «[...] I vetëdijshëm deri aty se është një shkrimtar i rendit të dytë, që ashtu-kështu e tradhton origjinalin, ai është tani një tradhtar ndaj kulturës së tij, sepse nuk favorizon daljen e veprave origjinale», shkruan Michel Ballard⁽⁵⁾. Është e mundshme, por përkthyesi favorizon daljen e gjuhës origjinale që përkthen. Një gjuhë, e cila është e aftë t'i kristalizojë mendimet e folësve të tij, por edhe atë të gjuhëve të tjera, mund të jetë krenar gjuhësisht.

Dhe «derisa nuk e ndiejmë çuditshmërinë, por të huajën, përkthimi ka përmbushur misionin e tij të lartë; mirëpo aty ku çuditshmëria duket brenda vetes dhe ndoshta edhe e errëson të huajën, atëherë përkthyesi nuk është në nivel të origjinalit të tij»⁽⁶⁾.

Është e vërtetë se «besnikëria ndaj origjinalit, parim të cilin pa dallim e përqafojnë të gjithë përkthyesit dhe që, megjithatë, shpie në kontradiktat më të çuditshme, pa dyshim është nocioni qendror i debatit rreth përkthimit dhe çdo shekull e nxjerr prapë dosjen»⁽⁷⁾.

1. Jean Delisle et Judith Woodsworth, Les Traducteurs dans l'histoire, Ottawa, Editions Unesco, 1995, couverture

2. Actes du colloque international tenu à l'E.S.I.T., La liberté en traduction, Paris, Didier Erudition, 1990, p.27

3. Edmond Tupja ProTranslatore, Tirana, Ombra GVG, 2004,

4. Jean-Claude Gémard, Traduire, ou l'art d'interpréter, Québec, Presses Universitaires de Québec, 1995, p.10

5. Michel Ballard, Europe et traduction, Ottawa, Presses de l'Université d'Ottawa, 1998, p.20

6. Michaël Oustinoff, La Traduction, Paris, PUF, Que sais-je ?, 2003, p.51

7. Amparo Hurtado Albir, La Notion de fidélité en traduction, Paris, Didier Erudition, 1990, p.21

Më duket se nocioni qendror është: «Çka të përkthejmë?», «Si të përkthejmë?», «Nga kush të përkthejmë?», «Ku të përkthejmë?», «Kur të përkthejmë?», «Për kë të përkthejmë?» dhe «Përse të përkthejmë?». Ndërkaq, vetë misioni i përkthimit: besnikëria e mendimeve, mund t'ua lërë vendin «armiqve të së vërtetës».

Në pjesën e tij më të madhe, ky libër bazohet në fjalët e shkrimtarëve, në përshkrimin e shkurtër të gjendjes së përkthimit në Kosovë dhe në një hulumtim cilësor të zhvilluar në vend.

Përzgjedha të mbështetem në pohimet e autorëve të tjerë për të mos ia lënë vendin vetmisë së përkthyesit.

Përzgjedhja ime ishte që të mos e filloja punën vetëm duke e përshkruar gjendjen e Kosovës, por të jepja një vështrim të përgjithshëm mbi përkthimin dhe komunikimin, sepse ajo ka të bëjë me të gjitha vendet.

Midis shkollave të përkthimit me orientim «drejt cakut» (saktësia e fjalëve në dëm të stilit) dhe «burimore» (së pari stili), ka burime që do të duhej ta shënjonin komunikimin, të vërtetin. Gjatë një sondazhi të vogël, të gjithë nxënësit e mi të një klase V, në Histori të Religjioneve parapëlqyen të thoshin: «Më mirë është të pihet kokakolë në një gotë të plastikës sesa ujë në një gotë të kristaltë».

Të përkthesh mirë në kushte të këqija është më mirë se të përkthesh keq në kushte të mira.

Qeveria zvicerane për herë të parë ka emëruar një të deleguar për shumëgjuhësi⁽¹⁾. Ky është një veprim i jashtëzakonshëm, por jo i papritur në një shtet katërgjuhësor.

Kur do ta kemi guximin kulturore të qeverive në Evropë, Zvicër dhe Kosovë, për ta themeluar Ministrinë e Përkthimit dhe Komunikimit Ndërkulturor?

1. Michel Guillaume : Plurilinguisme – Un geste politique fort pour les latins, L'Hebdo, 19 août 2010, p.21

Shtojcë

**HULUMTIM KUALITATIV
NË KOSOVË MBI TEMËN E
«PËRKTHIMIT DHE KOMUNIKIMIT»**

REFLEKSIONE DHE HIPOTEZA

Ky studim formulon disa hipoteza mbi rolin e rëndësishëm që përkthimet mund të luajnë në situatat e komunikimit, duke filluar nga pyetjet si në vijim:

1. Cilin rol mund të luajë përkthimi midis bashkëbiseduesve të gjuhëve të ndryshme në Kosovë?
2. Cilin rol mund të luajë përkthimi midis banorëve të Kosovës dhe atyre jashtë saj? Jemi përpjekur të kuptojmë se si përkthimet mund ta luajnë një rol «interferues» të ndërmjetëm, jo domosdo gjithnjë në shërbim të një komunikimi më të mirë dhe duke u nisur nga një komunikim më i mirë. Për asnjë çast, hulumtimi ynë nuk synon të vërë në dyshim rolin e përkthimeve në komunikim, përkundrazi, ai është përpjekur ta kuptojë rolin dhe mënyrën që e kryen përkthimi.

Tri refleksione kanë qenë shtyllat e një hulumtimi kualitativ:

- Kuadrot nuk janë të aftësuara në fushën e përkthimit dhe komunikimit.
- Përkthimi në Kosovë është ndikuar nga filtrimet ideologjike (përfshirë ato nacionaliste).
- Përkthimi në Kosovë është i njëanshëm, që do të thotë se përkthimet burojnë nga jashtë në Kosovë, e jo anasjelltas.

Këto tri refleksione çojnë në drejtim të hipotezës sonë kryesore:

Përkthimi mund të luajë edhe një rol negativ në situatat e komunikimit.

Ky hulumtim më ka shtyrë të studioj në një kontekst «in vivo»: në një shtet të ri, një administratë të re, me të gjitha strukturat e saj të reja, përfshirë shkollat në të gjitha nivelet, rrugët, ekonominë dhe madje edhe dokumentet e identitetit; shkurt, në një shtet që ka pranuar një identitet të ri shtetëror.

Në çfarë bazash ky shtet i ri dhe banorët e tij komunikojnë me botën e jashtme, pas dekadave të shkëputjes së komunikimit, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit?

Rënia e murit të Berlinit, fundi i luftës së ftohtë dhe ndarja e botës në kampe ideologjike, përparimet teknologjike, sidomos mjetet e transportit dhe demokratizimi i çmimeve, luajnë një rol mbizotërues, mbase vendimtar në një epokë të re të komunikimit. Këto ndryshime, që datojnë nga së paku 20 vjet më parë, e kanë gjetur Kosovën të shkëputur nga bota. Pas përfundimit të luftës, më 1999, vendi ka pritur deri më 2008 për ta gëzuar të drejtën për të pasur Ministri të Jashtme. Ende sot, shtetasit kosovarë, që kanë pasaportë të Kosovës, nuk mund të qarkullojnë lirshëm as nëpër Bosnjë dhe as nëpër Serbi, si dy shtete të cilat nuk e kanë njohur as pavarësinë e Kosovës, as dokumentet e udhëtimit, e madje as targat e automjeteve.

Kosova mbetet rajoni i fundit i Evropës, që nuk ka asnjë marrëveshje të liberalizimit të vizave Shengen, përderisa më se një e treta e popullatës së Kosovës jeton në Evropë, sidomos në Gjermani dhe në Zvicër (ku jeton rreth 10% e popullatës së Kosovës dhe ku nuk ka pothuajse familje që nuk ka ndonjë lidhje familjare me Zvicrën). Prej këtej edhe një lloj frustrimi, për shkak të mungesës së komunikimit midis familjeve, miqve dhe të afërmeve ose edhe gjatë 10 vjetëve, ndalesa për një pjesë të madhe të diasporës kosovare të kthehej lirisht në Kosovë.

Kosovarët shqipfolës, sidomos pas mbylljes së shkollave (1990-1999), janë organizuar mirë e keq, në shtëpitë private, për ta siguruar mësimin edukativ, me mjete elementare, pa mjete të nevojshme pedagogjike (tekste, mësimdhënës, laboratorë etj.), pa kushte minimale të nevojshme (hapësirë, ngrohje, ujë etj.) dhe pa paga (kontributi i diasporës, të organizuar sidomos përreth shoqatës Nëna Tereze, ka mundur, megjithatë, t'u jepet mësimdhënësve një shumë të hollash mujore për t'ua siguruar një minimum jetik për ushqime). Për shembull, ligjëratat e vitit të dytë të mjekësisë zhvilloheshin në disa lagje: anatomia në një lagje, histologjia në një tjetër ose fiziologjia në periferi.

Pas luftës së vitit 1999 (pothuajse gjysma e popullatës ishte dëbuar për disa muaj dhe rreth 80'000 shtëpi ishin djegur nga forcat serbe, në emër të 'politikës së tokës së djegur'), vendi përngjante në një kantier ndërtimi. Më se 120'000 shtëpi janë rindërtuar ose janë ndërtuar me ndihmën e Kombeve të Bashkuara, vendeve perëndimore, diasporës dhe vendorëve (kryesisht familje modeste, por edhe të pasur të rinj, tregtarë, por edhe përkthyes, që punonin me organizatat ndërkombëtare).

Shteti ringrihet ose lind, si të duam, por jo pa vështirësi të mëdha.

Ekonomia ka vështirësi të ngrihet, përderisa papunësia (numri i papunësisë, sepse nuk ekziston asistencë sociale siç e njohim në Zvicër) përbën më shumë se 40% të popullatës (2010). Popullata kosovare është më e reja në Evropë.

Sipas disa studimeve⁽¹⁾, më se 90% e të gjitha produkteve (ushqimore, teknike, mekanike etj.) në Kosovë vijnë nga jashtë dhe vetëm 10% janë produkte vendore, përderisa vendi ka burime të mëdha minerare dhe bujqësore, pyje të bollshme dhe burime të ujit.

Kam dashur ta përshkruaj kontekstin sociologjik, ekonomik dhe politik, sepse zhvillimi i përkthimit nuk mund të kapet, nëse shkëputet nga konteksti i përgjithshëm; pra, përkundrazi, përkthimi zhvillohet me kontekstin.

1. RTK, août 2010, *journal de 19h30*

Gjatë dy intervistave që zhvilluam në tarracat e Prishtinës (sipas dëshirës së personave që pranian t'i përgjigjeshin pyetësorit tim), numri i lypësve që vinin pandërprerë drejt nesh ishte shumë i numërt: 7 gjatë intervistës së parë dhe 4 gjatë së dytës, edhe pse nuk ndodheshim në vendet më të ekspozuara. Shumica ishin romë, por edhe fëmijë shqiptarë, lypës ose shitës të cigareve, të kartave telefonike ose çamçakëzëve.

Duke qenë njëkohësisht në mëdyshje, isha «i lumtur» të punoja kështu në një kuadër natyror, sepse ndodhesha në gjendjen siç është në të vërtetë në jetën e përditshme.

QËLLIMI I HULUMTIMIT DHE ELEMENTET E METODOLOGJISË

o Gjendja e letërsisë dytësore: një mungesë e shprehur e studimeve mbi përkthimin dhe komunikimin në Kosovë, më ka motivuar të ndërmarrë këtë studim.

o Kam zbatuar një hulumtim kualitativ për këtë studim.

o Për grumbullimin e të dhënave kisha nevojë për informatat që paraqitnin një vështrim të përgjithshëm të përkthimit dhe të komunikimit brenda Kosovës, por edhe jashtë saj.

o Kam zgjedhur, si rrjedhojë, bashkëbisedues të privilegjuar, në një mostër domethënëse të popullatës, nga pikëpamja cilësore, që përfaqësonte më së miri dukurinë e trajtuar në këtë hulumtim.

o Duke qenë se banoj në Zvicër, kam zgjedhur një numër të vogël të njerëzve, pra vetëm dhjetë sosh.

o Kriteret e përzgjedhjes: mosha «tranzitore», pra midis 30 dhe 50 vjeç, që kanë përfunduar përgatitjen e tyre profesionale, që kanë njohur gjendjen para luftës, që kanë punuar në korniza institucionale ose që kanë qenë profesionistë dhe që kanë një vështrim të përgjithshëm të problematikës.

o Kriteret e shumëllojshmërisë janë marrë po ashtu në konsideratë: 5 meshkuj dhe 5 femra, të profesioneve të ndryshme dhe të rajoneve të ndryshme të Kosovës.

o Si instrumente për t'i grumbulluar këto informata (në mesin e katër teknikave të mundshme: vëzhgimi, intervista individuale, intervista grupore dhe përdorimi i dokumenteve), kam përzgjedhur intervistat individuale me mbështetjen e një pyetësoi të hartuar paraprakisht.

o Kam vepruar me induksion, për sa i përket teorisë së hulumtimit.

o Konceptet ishin të hapura dhe janë ndërtuar përgjatë hulumtimit; hipotezat fillestare u konfirmuan në fund.

- o Roli im ishte empatik, përderisa roli i subjekteve të studiuara ishte aktiv.
- o Përzgjedhja ime metodologjike është ndërtuar me shkathtësi gjatë hulumtimit tim, përderisa të dhënat janë grumbulluar duke marrë shënime. Meqë dy persona nuk pranuan të incizohen, kam marrë shënime me shkrim, duke ua dërguar shënimet për rilexim, për të qenë të sigurt rreth formulimit dhe besueshmërisë së pohimeve të tyre. Është ruajtur spontaniteti, por intervistat kanë qenë më të ngadalshme për shkak të rileximit të tyre.
- o Kam kryer vetëm një herë dy intervista në të njëjtën ditë, ndërsa kam bërë një intervistë në ditë.
- o Qëllimi i kësaj analize të të dhënave ishte individi, përderisa qëllimi i analizës ishte kuptimi i konteksteve të saj të komunikimit.
- o Paraqitja e të dhënave është narrative, e shoqëruar me pjesë të përgjigjeve. Për ta lehtësuar leximin dhe paraqitjen e të dhënave, do t'i rimarr të gjitha pyetjet dhe do t'i paraqes njërën pas tjetrës, me pjesët kuptimplota të përgjigjeve ose të atyre që më kanë munguar.

**Hulumtimi im përmban elemente të një hulumtimi cilësor, elementet kryesore të të cilit janë bazuar në ligjëratat e Prof. dr. Maria Caiata Zufferey /Masteri Komunikim Ndërkulturor/Universiteti i Luganos.*

o Sa i përket paraqitjes së personave që kanë marrë pjesë në intervistat individuale, ky është profili i tyre:

1. Bardha Rrustemi, Drejtore e Drejtorisë së Reformave të Administratës Publike. Ka studiuar në Francë, F.
2. Bekim Jakupi, Menaxher i Thesarit të KEK-ut, Korporatës Energjetike të Kosovës (furnizuesi kryesor i rrymës në Kosovë). Ka studiuar në Angli (Londër), M.
3. Besa Bytyçi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Informimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, F.
4. Besim Kajtazi, Drejtor i Drejtorisë Ligjore pranë kabinetit të Kryeministrit, M.
5. Florina Haziri, Mësimdhënëse e gjermanishtes, Drejtoreshë e një shkolle të gjuhëve. Master në Gjermani, F.
6. Mirsad Krasniqi, Ish-bashkëpunëtor i Rilindjes (shtëpia më e madhe botuese dhe gazeta kryesore deri më 1999), aktualisht shitës i librave në rrugë, M.
7. Naim Jerliu, Ish-nënkryetar i LDK-së (partia e Presidentit). Mjek, këshilltar politik i presidentit Sejdiu. Doktorant në Maastricht (Holandë), M.
8. Nerimane Kamberi, Profesoreshë e gjuhës frënge në Universitetin e Prishtinës. Shkrimtare, përkthyes, përgjegjëse e Qendrës Kulturore Franceze në Prishtinë. E lindur në Namur (Belgjikë). Banon pranë Ferizajt, F.
9. Ramadan Hoxha, Master në përkthim të letërsisë mesjetare franceze, në Francë (Besançon), M.
10. Violeta Gagica, Përgjegjëse e Librarisë «Dukagjini» (Aktualisht libraria më e madhe e Kosovës), F.

Shpjegim:

o Tre persona kanë dashur të përgjigjen në frëngjisht, (B. RR., R. H., dhe N. K.), përderisa shtatë të tjerë janë përgjigjur në shqip.

o Të gjithë këta persona punojnë në Prishtinë. Përveç njërës, N. K., të gjithë banojnë në Prishtinë.

o Data e intervistave: gjatë vitit 2010.

REZULTATI I INTERVISTAVE

a. Kuptimi i dhënë përkthimit

Gjatë intervistave, secili dhe secila kishte konceptin e tij/saj të përkthimit. Shumë përgjigje më duken interesante për t'u përmendur, sepse ato reflektojnë paralelet që këta bashkëbisedues tërheqin midis përkthimit dhe komunikimit, transmetimit dhe kuptimit të tjetrit:

- Mënyra e të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit dhe të transmetuarit të kuptimit sa më drejt. Ky është transmetim i normave dhe mendimit të një kulture në tjetrën. (R.H.)
- Përkthimi është një transmetim, i drejtë, nga një gjuhë në tjetrën. (B.B.)
- Përkthimi është komunikim. (B.K.)
- Të hysh në lëkurën e atij që shkruan. (...) Takimi i një zëri, i një teksti, i një shpirti, i tjetrit. (N.K.)
- Përkthimi është të transmetosh dhe të bartësh njëkohësisht. (N.J.)
- Përkthimi është një formë e interpretimit të fjalëve. (B.RR.)

b. Dallimi midis përkthimeve letrare dhe teknike

Të gjithë bashkëbiseduesit e bëjnë lehtë dallimin midis përkthimeve teknike dhe letrare. Disa prej tyre kanë dashur ta formulojnë më qartë këtë dallueshmëri:

- Ka një bazë të përbashkët për të dyja. Por, përkthimi letrar e prek më shumë stilin, përderisa përkthimi teknik e prek më shumë anën praktike (V.G.).
- Përkthimi letrar kërkon një kulturë gjuhësore dhe socio-historike të të dy gjuhëve të shënuara, përderisa përkthimi teknik kërkon një njohuri për temën e trajtuar (R.H.).
- Përkthimi teknik kërkon një saktësi të madhe, përderisa përkthimi letrar është i përshtatur dhe mundëson më shumë liri interpretimi. (B.B.)
- Absolutisht. Edhe pse përkthimi letrar ka pak teknikë (...). (N.K.)

c. Vendi i përkthimeve në shoqërinë kosovare

Përgjigjet qenë shumë të ndryshme, sepse pyetja, siç e vërejta, ishte e hapur dhe mundësonte shumë interpretime mbi vendin e përkthimeve letrare, teknike ose edhe me gojë, në shoqërinë e Kosovës.

Përderisa B.J. thotë: «Përkthimi është shumë i rëndësishëm. Nuk funksionon asgjë pa të», R.H. thotë: «Shumë pak. Pothuajse fare përkthime letrare.»

Kjo pyetje e madhe, që nuk saktësonte as kuptimin, as gjininë, mundësoi të shihet se koncepti i fjalës 'përkthim' dhe vendi i tij në shoqërinë kosovare dallonte varësisht nga qendra e interesit dhe përvojat personale të njerëzve të intervistuar.

Personat që punojnë dhe që kanë poste me përgjegjësi vlerësojnë se «përkthimi ka një vend të rëndësishëm në shoqërinë kosovare», përderisa personat që kanë një qark interesi të orientuar mbi letërsinë, si N.K., thonë: «Për letrarët kosovarë, fjala përkthim është e ndërlidhur me Fan Nolin, shkrimtar, kryeministrin e Mbretit Zog të Shqipërisë, që ka përkthyer në mënyrë të shkëlqyeshme, pos të tjerash, Shekspirin. Për të tjerët janë librat universitarë, kryesisht të përkthyer nga gjuhët sllave. Sot, sigurisht se përkthimi nuk e ka vendin meritë në Kosovë; kjo sepse nuk e kanë këtë vend as letërsia dhe as kultura e përgjithshme».

d. Roli i përkthimeve në komunikim midis shqiptarëve të Kosovës me bashkësitë e tjera të Kosovës (serbët, turqit, romët, boshnjakët)

Të gjithë personat e intervistuar pohojnë se përkthimi zë një vend shumë të rëndësishëm në komunikimin midis kosovarëve shqipfolës dhe bashkësive të tjera të Kosovës, serbët, turqit, romët, boshnjakët dhe goranët. Ata saktësojnë se bashkësitë flasin vetëm gjuhën e tyre dhe se nga ky fakt i drejtohen përkthimit.

Disa bashkëbisedues e vënë në pah faktin se personat që flasin shqip bëjnë më shumë përpjekje për të komunikuar në gjuhën e bashkësive të tjera, veçmas në serbokroatisht. Mbase, ata e nënvizojnë faktin se të gjithë përkthyesit janë shqipfolës dhe se nuk ka përkthyes që burojnë nga bashkësitë minoritare.

Në fakt, shqiptarët, vetë minoritarë në ish-Jugosllavi, duhej të mësonin sidomos serbokroatishten, por edhe maqedonishten e sllovenishten, si për arsye profesionale, ashtu edhe për studime, për shërbimin ushtarak (prandaj edhe serbokroatishten e flasin më shumë meshkujt shqiptarë sesa femrat), edhe burgun etj..

Pakica aktuale serbe në Kosovë e flet shumë pak shqipen dhe nuk është ndonjë rastësi nëse janë shqiptarët ata që punojnë si përkthyes. Por, edhe dhe sidomos, për t'i siguruar përkthyesit, duhet kërkuar në mesin e më të moshuarve, sepse rinia shqiptare e sotme e Kosovës flet shumë pak serbokroatishten.

Turqishtja përmendet po ashtu si gjuhë e komunikimit nëpërmjet përkthimit (R.H.), por është edhe fakti «se disa turqishtfolës në Kosovë ankohen se gjuha turke e përdorur nga përkthyesit nuk përputhet me gjuhën standarde të Turqisë.» (V.G.)

«Bashkësitë komunikojnë nëpërmjet ligjeve dhe OJQ-ve », sipas N.K.

e. Vendi i përkthyesve në komunikim midis kosovarëve dhe «ndërkombëtarëve» në Kosovë (UNMIK, KFOR, EULEX, OJQ, Këshilli i Evropës, OSBE etj.)

Të gjithë pjesëmarrësit vënë në pah faktin se komunikimi midis ndërkombëtarëve dhe kosovarëve në masë të madhe bëhet nëpërmjet përkthimit, ndoshta edhe krejtësisht. Ata janë përgjigjur se kosovarët janë ata që e bëjnë hapin e parë dhe që njohin më mirë gjuhët e huaja, përderisa «ndërkombëtarët » nuk e njohin gjuhën shqipe dhe nuk i bëjnë përpjekjet e nevojshme për ta mësuar dhe për të komunikuar në gjuhën e shumicës.

Megjithatë, mendimet janë pak të ndara lidhur me përpjekjet e mësimit dhe komunikimit të gjuhës së tjetrit. V.G. pohon se ka më shumë përpjekje të komunikimit dhe mësimit të gjuhës shqipe nga ana e ndërkombëtarëve sesa nga kosovarët. Mendoj se kjo vjen nga fakti se V.G. punon në një librari ku ndërkombëtarët janë klientët kryesorë dhe blejnë sidomos libra mbi Kosovën, veçanërisht dhe, nga ana tjetër, kosovarët blejnë, për shembull, fjalorë. V.G. përmend edhe situatën e një femre me prejardhje etiopiane, që filloi ta mësonte shqipen. Fjalorët që shiten në rrugë, disa metra nga libraritë, kushtojnë dy herë më lirë se në librarinë përkatëse.

M.K., shitës i librave në rrugë, thotë sikur V.V. se «ka përpjekje nga ndërkombëtarët për ta mësuar gjuhën» dhe përmend faktin se «ata janë edhe blerës të fjalorëve, ata të vendeve veriore janë më të kërkuar, por ata mungojnë», sipas M.K.

Këta dy persona, që punojnë në shitjen dhe në shpërndarjen e librave, e thonë pra të kundërtën, sa u përket përpjekjeve për mësimin e gjuhës.

«Rregulloret e UNMIK-ut, udhëzimet për zgjedhjet nga OSBE-ja, projektet e Këshillit të Evropës, afishet që e promovojnë tolerancën nga KFOR-i, e përditshmja e kosovarëve është e mbushur me përkthime, leksione, por kemi më shumë të bëjmë me komunikim në distancë. Aspekti njerëzor kalon nëpërmjet letrës. Ose nëpërmjet zyrave ku punojnë kosovarët», thotë N.K., në vend të përmbljedhjes.

Komunikimi midis kosovarëve dhe ndërkombëtarëve duket më i lehtë se komunikimi midis kosovarëve dhe gjuhëve të ndryshme. «Mendoj se në këtë rast, roli i përkthimeve nuk është aq i rëndësishëm sa ai i shqiptarëve me bashkësitë e tjera, sepse një pjesë e madhe e shoqërisë ka njohuri të nevojshme për të komunikuar me ndërkombëtarët», thotë F.H.

B.RR. lidhur me këtë çështje, midis të tjerash, thotë që ky «komunikim nuk është gjithëherë i përsosur, sepse ekziston rreziku që fjalët të «filtrohen» ose të «keqtransmetohen», por kjo është një pjesë e pashmangshme».

f. Përvoja personale në përkthim

Vetëm një person thotë se nuk ka bërë përkthime (M.K.). Dy persona thonë se janë përkthyer (N.J. dhe B.K.).

Shumica (shtatë) thonë se kanë bërë përkthime me gojë, përveç dyve, që kanë bërë përkthime letrare: letrare dhe administrative për R.H. dhe N.K. (prozë, poezi, tekste ligjore, ekstrakte librash mjekësie, filma).

Lidhur me përkthimet, N.K. shton se «parapëlqen interpretimin për shkak të këmbimeve, kontaktit njerëzor, terrenit...». Vetmia e përkthyesit e frikëson, sidomos kur duhet përkthyer qindra faqe të një romani.

g. Njohja e përkthyesve dhe e punës së tyre

Të gjithë pjesëmarrësit thonë se njohin përkthyes. Disa saktësojnë se njohin emra ose gjuhë, si B.J. (përkthyes për anglishten, gjermanishten, serbokroatishten, turqishten, arabishten, italishten dhe frëngjishten).

B.B. saktëson se është ballafaquar me mungesën e përkthyesve të njëkohshëm, shumë të kërkuar, sipas saj. N.J. thotë gjithashtu se ka njohur përkthyes mullahë, që bëjnë më shumë interpretime, se përkthime të komentimeve dhe të Kuranit.

Ajo që më duket e rëndësishme në këtë pjesë është lehtësia me të cilën të gjithë pjesëmarrësit thonë se njohin përkthyes, përderisa, sa për krahasim, gjatë punës sime në kantonin e Vaudit (Zvicër), në fushën sociale ose të banimit, jam ballafaquar disa herë me kolegë, që nuk njohin as veprimet që duhen ndërmarrë dhe as përkthyesit, të cilët madje shpeshherë nuk dëshironin të ftoheshin.

h. Njohja e përkthimeve të shqipes në gjuhë të tjera dhe anasjelltas

Lidhur me këtë temë, shumica e pjesëmarrësve janë përgjigjur se përkthimet, sidomos letrare, bëhen në mënyrë të njëanshme: pak bëhen nga shqipja drejt gjuhëve të tjera dhe pjesa dërrmuese e përkthimeve bëhet nga gjuhët e tjera në shqip. B.B. thotë se e njeh këtë dukuri ku ka «shumë më shumë përkthime të gjuhëve të tjera në shqip, porse nuk ka përpjesëtime të vërtetuara nga ndonjë studim i mundshëm».

N.K. saktëson, megjithatë, se janë të përkthyer disa autorë, si «Kadare, përkthimi i të cilit është vepër mjeshtërore» dhe që «autorët e mëdhenj të letërsisë botërore, si: Pamuk, Abate, Ishiguro etj.» janë të përkthyer në gjuhën shqipe. Lidhur me këtë çështje, V.G. thotë se ka njohuri që rreth 1000 vepra janë të përkthyer. Ajo e përmend ndjenjën e inferioritetit nga ana e disa personave dhe medieve, sipas saj, sidomos «KTV, i cili paraqet pandërprerë qe disa muaj reklama për librat e autorëve të shteteve fqinjë».

Duhet shtuar se përpjesëtimi i përkthimeve duket i baraspeshuar në të dy anët, për sa u përket dokumenteve zyrtare (B.K.), akteve normative dhe raporteve (B.RR.), fjalimeve politike (N.J.) dhe kontratave (B.J.).

i. Vendi i përkthimeve letrare dhe teknike të gjuhëve të huaja në Kosovë

Sipas disa pjesëmarrësve, ka «shumë pak përkthime letrare të bëra në Kosovë, përderisa në Shqipëri ka «dyndje të përkthimit» (M.K.).

Mbase, Shqipëria duket se e ka «kapur shumë shpejtë kohën e humbur dhe është ngutur të përkthejë shumë autorë, nganjëherë keq, por më shpesh mirë. Kosova nuk e ka ndjekur këtë ritëm, megjithë përpjekjet e saj », thotë N.K. Letërsia për fëmijë është një shembull i mirë i stimulimit të përkthimit të teksteve në gjuhë të huaja për Kosovën. Përderisa mungon letërsia shkencore sipas disa bashkëbiseduesve si B.J. dhe V.G.

Lidhur me përkthimet teknike (produktet, ushqimet, barnat), duket se ato mungojnë dhe sipas M.K., «ka stagnim, ndoshta edhe regres, kundrejt gjendjes së para luftës».

Lidhur me përkthimet e ligjeve dhe dokumenteve zyrtare, sipas B.K., një punë e madhe është bërë në Kosovë. B.RR. mendon «që nuk duhet folur për vendin, por për cilësinë e përkthimeve».

Mund të vlerësohet se përkthimet letrare janë mjaft të pranishme në Kosovë, porse këto përkthime në masë të madhe bëhen në Shqipëri.

Duhet saktësuar se kjo gjendje nuk daton nga dje : që disa dekada, pjesa më e madhe e përkthimeve të autorëve të huaj vijnë nga Shqipëria.

Përkthimet e produkteve me prejardhje nga jashtë (ushqime, teknika, barnat etj.) janë të pakta, edhe pse janë bërë tanimë përpjekje që një kohë, aq më tepër që po krijohet legjislacioni për përdorimin e gjuhëve.

Lidhur me përkthimin e dokumenteve zyrtare, në përputhje dhe në bashkëpunim me UNMIK dhe/ose EULEX, KFOR, OSBE, Këshillin e Evropës, shumë organizata shtetërore dhe OJQ, mund të konstatojmë se janë bërë përparime të mëdha, si në nivelin komunal, ashtu edhe në atë të administratës qendrore.

Dokumente të të gjitha këtyre instancave shpërndahen gjithkund në disa gjuhë në Kosovë. Pa harruar dokumente të rrymave të ndryshme fetare, sektare dhe të tjera, që garojnë midis tyre për t'u shpërndarë në Kosovë.

j. Vendi i përkthimeve të autorëve kosovarë në gjuhë të tjera

Sipas të gjithë pjesëmarrësve, ka shumë pak shkrimtarë kosovarë që janë të përkthyer në gjuhë të huaja. B.RR., megjithatë, mendon se «duhet bërë një studim lidhur me këtë çështje, nga aty ku janë bërë, ato janë të kënaqshme (në kuptim të cilësisë)».

Ndërkaq, B.K. saktëson se «ka pak njohuri lidhur me letërsinë, por se di përkthime të rëndësishme të raporteve dhe të hulumtimeve që janë bërë për organizatat ndërkombëtare, si për UNIFEM-in».

Përkthimet e kryera në gjuhë të tjera duhen kërkuar në nivel të dëshmvive (për shembull, gazetareske), dëshmitarëve (shumica e tyre të mbrojtur) për gjykata të ndryshme, sidomos për Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës.

«Shumë pak, 4 ose 5 autorë gjithsej», sipas M.K. ose «shumë pak, përveç disa përjashtimeve që kanë të bëjnë me poezinë në disa antologji, pak teatër, por romani shumë pak», sipas N.K.

«Disa libra të autorëve kosovarë, të shkruar në gjuhët e huaja dhe të përkthyer e të botuar në Kosovë, mbeten në Kosovë dhe nuk janë të shpërndarë jashtë vendit», saktëson V.G..

Disa bashkëbisedues përmendin një shembull, aty-këtu, të autorëve të Kosovës, të përkthyer jashtë vendit, si Qosja (F.H.), Çapriqi (B.B. dhe N.K.) ose autorë të tjerë që janë përkthyer (Ragip Sylaj, Ali Podrimja), por nuk njohin gjuhën në të cilën janë përkthyer (B.B.).

N.J. saktëson se një shtet, Rumania, ka pak hapësirë për poezinë e autorëve kosovarë. «Vendi i përkthimeve letrare është i pranishëm, por pak i njohur», sipas R.H.

Rastësi e mirë. Pas një interviste me B.RR. (gusht, 2010), shkoi në Pallatin e Rinisë për ta përshëndetur Remzi Limanin, artist, poet dhe përgjegjës i seksionit kulturor të Pallatit përkatës. Remzi Limani më jep një nga librat e tij, të përkthyer në rumanisht dhe të botuar në Rumani pak ditë më parë. «Ç’do të thotë për ty përkthimi letrar?», pyes Remzi Limanin. «Njëherësh duhet ta di se ç’është përkthyer, që të mund të të them se ç’është përkthimi letrar», më përgjigjet ai. I përgjigjem: «Po, kjo varet nga ata që përkthejmë dhe aty është ndoshta vetë çelësi i punës sime».

Vërehet se autorët kosovarë janë pak të përkthyer, ose pothuajse fare, në gjuhë të tjera; porse pyetja e vërtetë në të ardhmen do të jetë të dihet: «Çfarë të përkthehet?» dhe «Si?»

k. Një komunikim i mirë dhe i thellë ose i keq nëpërmjet përkthimeve

Lidhur me këtë pyetje, të paraqitur pa shumë saktësim, sa i përket mënyrës së përkthimit, llojeve dhe përzgjedhjeve të përkthimeve, kam disa përgjigje.

Këto përkthime janë «sipërfaqësore» në sytë e personave të intervistuar. Së pari «pak, pastaj jo edhe me aq kritere» (M.K), «të dobët, të njëanshëm dhe të pandërsjellë» (B.J.) ose «këto përkthime janë letargjike, ato reflektojnë një komunikim të fjetur [...]», sipas N.K.

Për B.K., B.B., ose R.H., këto përkthime reflektojnë një komunikim të mirë.

N.J. dhe B.RR janë të ndarë (B.RR. thotë se «është e vështirë të jepet një cilësim i prerë për këtë çështje) përderisa F.H. thotë se «nuk ka pasur rast ta lexojë një autor të përkthyer kosovar, që të mund të gjykojë nëse është përkthimi i mirë».

Kjo pyetje, më duket, do të kishte mundur t'i bëjë pjesëmarrësit të gabojnë, duke e interpretuar si të diturit «nëse përkthimi luan ose duhet ta luajë një rol në komunikim». Nuk kam dashur të sjell shumë saktësime gjatë intervistave, sepse më dukej e rëndësishme të shoh se si pjesëmarrësit e kuptonin këtë pyetje dhe krijonin përgjigjet. Rezultati, disa pjesëmarrës më janë përgjigjur gjatë intervistave në kuptimin se: «përkthimi është i mirë në komunikim...».

I. Masat që duhen ndërmarrë, aq të nevojshme, për ta përmirësuar këtë gjendje

Të gjithë pjesëmarrësit vlerësojnë se duhet të përmirësohet gjendja.

Disa prej tyre kërkojnë ta përmirësojnë gjendjen e tanishme përmes institucioneve (N.J., B.K., M.K.), sepse, siç thotë M.K.: «Individët nuk mund ta zgjidhin një çështje të tillë kaq jetike».

Përmirësimi i kësaj gjendjeje duhet kërkuar nëpërmjet aftësimit të përkthyesve (B.B., V.G., B.RR. ose N.J.), inkurajimit të hulumtimit në fushën e përkthimologjisë (R.H.), nxitjes së më shumë financimeve për përkthime (B.B., N.J.), investimit njerëzor dhe financiar në kulturën e përgjithshme (N.K.), për shtëpitë botuese (B.J. et V.G.), përzgjedhjes së teksteve, si dhe përmirësimit të bashkëpunimit midis autorëve dhe përkthyesve (F.H.).

Lidhur me këtë çështje është interesant të konstatohet se të gjithë pjesëmarrësit pajtohen se duhet përmirësuar gjendja, porse masat e propozuara janë heteroklite.

m. Mesazhi ose këshilla për autorin e këtij punimi

Nga këshillat kryesore që kam marrë, do të doja t'i përmendja këto: «Vazhdo më tej.» (M.K.), «Kujtoji vështirësitë që ke pasur gjatë përkthimeve dhe kënaqësinë që ke ndier» (N.K.), «Kontribuo në përforcimin profesional këtu» (V.G.), «Personat që kanë pak njohuri, kanë më shumë gjasa të krijojnë keqkuptime, se ata që nuk kanë fare ose shumë njohuri. Gjithçka fillon me hulumtimin dhe duhet vazhduar më tej» (B.B.), «Mëso nga gabimet e të tjerëve dhe nga shembulli i Bosnjës, për sa i përket përkthimit» (N.J.).

PËRFUNDIM(E)

Për rikujtim, ky studim, kishte për qëllim tri refleksione:

- o Kuadrot nuk janë të aftësuara në fushën e përkthimit dhe komunikimit.
- o Përkthimi në Kosovë është ndikuar nga filtrimet ideologjike.
- o Përkthimi në Kosovë është i njëanshëm, do të thotë përkthime që vijnë nga jashtë në Kosovë, por jo nga Kosova jashtë saj.

Kuadrot nuk janë të aftësuara në fushën e përkthimit dhe komunikimit (pyetësi i parë). Lidhur me këtë çështje, vlerësoj se bashkëbiseduesit tanë trajtonin me thellësi çështjen e përkthimit dhe komunikimit.

Përvoja e tyre profesionale, rrugëtimet e tyre personale dhe përjetimet e tyre u jepnin atyre një lehtësim për ta trajtuar temën. Megjithatë, ky përfundim, me këtë mostër të popullatës, nuk mund të verifikohet.

Lidhur me dy refleksionet e tjera, ato pothuajse janë vërtetuar gjatë intervistave:

Po, përkthimi, sidomos letrar, ai i produkteve të të gjitha llojeve, bëhet në mënyrë të njëanshme: nga jashtë në Kosovë.

Po, përkthimet në Kosovë janë «filtruar» nga regjimi i ish-Jugosllavisë. As tekstet e autorëve kosovarë, as dëshmitë e tyre, nuk janë përkthyer në gjuhët e huaja, përderisa në ish-Jugosllavi kishte një traditë të madhe të përkthimit letrar, siç e dëshmojnë dy kongreset vjetore të Federatës Ndërkombëtare të Përkthyesve (më 1963 në Dubrovnik dhe më 1990 në Beograd)⁽¹⁾.

Përkthyesit letrarë kosovarë nuk ishin të stimuluar, të aftësuar, të inkurajuar, të mbështetur gjatë dekadave. Studimet në fushën e përkthimit janë pothuajse të paqena dhe institucionet nuk kanë bërë me sa duket ndonjë gjë në këtë fushë. Përkthimet, sidomos shkencore, rridhnin nga serbokroatishtja, përderisa ato letrare nga Shqipëria. Këto të fundit ishin së pari të «filtruara» ideologjikisht, në Shqipëri, dhe pastaj, për së dyti, nga regjimi nacionalist në pushtet në Beograd.

Një filtrim i dyfishtë: ideologjik dhe nacionalist.

Gjendja e përshkruar pas luftës, më 1999, nuk e ka ndihmuar fare çështjen e përkthimit, edhe pse aktualisht mund të vërehen disa përparime. Pas shumë përkthimeve të nxituara (ushtarake, policore, dokumente zyrtare, produkte,

1. Source: <http://www.fit-ift.org/fr/chron-f.php>.

tekste fetare, dëshmi, barna etj.), mendimet rreth përkthimit kanë filluar të shpërfaqen.

Kur përkthimet bëhen në mënyrë pothuajse të njëanshme dhe që numri i tyre i vogël nuk përfundon me një përzgjedhje të menduar, atëherë përkthimi mund të luajë po ashtu një rol negativ në komunikim.

Thirrja në shërbimet e përkthyesit do ta lehtësonte komunikimin midis përbërësve gjuhësorë në Kosovë, por në një kohë afatgjate, kjo gjendje krijon «pengesa të komunikimit» që nuk e ndihmojnë aftësimin e ndërsjellë gjuhësor.

Mendoj se studimi im është i pamjaftueshëm. Disa «shkëndija» janë nxjerrë dhe shpresoj «ta ndezin zjarrin e mendimeve» dhe më vonë ta thellojnë temën me ndonjë studim të ri, me bashkëbisedues të tjerë, sidomos me ata nga minoritetet, sepse në këtë punim është e përfaqësuar vetëm pikëpamja e kosovarëve që flasin shqip.

BIBLIOGRAFIA

1. «ALBANIE (HISTOIRE ET LANGUE) OU L'INCROYABLE ODYSSEE D'UN PEUPLE PRÉHELLÉNIQUE», Mathieu Aref, Collection Mnémosyne, Paris, 2003
2. «APPROCHE HISTORIQUE DE LA TRADUCTION LITTÉRAIRE EN SUISSE», Alena Vacek, CTL-UNIL, Lausanne, 1995
3. «APPROCHE LINGUISTIQUE DES PROBLÈMES DE TRADUCTION», Hélène Chuquet et Michel Paillard, Editions Ophrys, Paris, 1987
4. «AUTOUR DE LA TÂCHE DU TRADUCTEUR», Paul de Man, Wilhelm von Humboldt et Barton Byg, TH&TH, Paris, 2003
5. «DE LA COHABITATION DES LANGUES», Iso Camartin, Mini Zoé, Carouge-Genève, 1999
6. «DES INTERPRÈTES POUR OUVRIR L'ACCÈS AUX SOINS», Aurélie Déspons, journal Uniscope-UNIL, Lausanne, 24 mai 2010
7. «EUROPE ET TRADUCTION», Michel Ballard, Artois Presses de l'Uni Ottawa, Ottawa, 1998
8. «FJALORI I GJUHËS SHQIPE» (DICTIONNAIRE DE LA LANGUE ALBANAISE), Mehmet Elezi, Gjergj Fishta, 2006
9. «IL FAUT BIEN TRADUIRE: MARCHES ET DÉMARCHES DE LA TRADUCTION», Philippe Forget, Ed. MASSON, Paris, 1994
10. «INTERPRÉTATION: ASPECTS SÉMANTIQUES ET PRAGMATIQUES», Lidia Fraczak et Franck Lebas, Presses Universitaires Blaise Pascal, Clermont-Ferrand, 2007
11. «KËSHILLA PËRKTHYESIT TË RI» (*CONSEILS AU NOUVEAU TRADUCTEUR), Edmond Tupja, p.7, Onufri, Tirana, 2000
12. «L'ÉCRIVAIN ET SON TRADUCTEUR...EN SUISSE ET EN EUROPE», sous la direction de Marion Graf, Editions ZOE, Carouge-Genève, 1998
13. «L'INTERPRÉTATION DU TEXTE ET LA TRADUCTION», Svetlana Vogeleer, Bibliothèque des cahiers de l'Institut de linguistique de Louvain, Louvain, 1995
14. «LA COMMUNICATION MULTILINGUE», Mathieu Guidère, Groupe De Boeck s.a., Bruxelles, 2008
15. «LA LIBERTÉ EN TRADUCTION», Marianne Lederer et Fortunato Israël, Collection Traductologie - Didier érudition, Paris, 1990
16. «LA MACHINE À TRADUIRE: HISTOIRE DES PROBLÈMES LINGUISTIQUES», George Mounin, Mouton&CO, London-Paris, 1964

17. «LA MACHINE À TRADUIRE», Emile Delaveay, Que sais-je PUF, Paris, 1972
18. «LA NOTION DE FIDÉLITÉ EN TRADUCTION», Amparo Hurtado Albir, Collection Traductologie - Didier érudition, Paris, 1990
19. «LA TRADUCTION DES JEUX DE MOTS», Jacqueline Henry, Presses Sorbonne Nouvelle, Paris, 2003-
20. «LA TRADUCTION LITTÉRAIRE», SCIENTIFIQUE ET TECHNIQUE, Collection Paroles&Actes, La Tilu éditeur, Paris, 1991
21. «LA TRADUCTION : DE LA THÉORIE À LA PRATIQUE ET RETOUR», Jean Peeters, Presses Universitaires de Rennes, Rennes, 2005
22. «LE BASQUE ET LES ÉLÉMENTS PRÉ-INDO-EUROPÉEN DE L'ALBANAIS», N. Lahovary, San Sebastian, 1958
23. «LE POINT SUR LE CADRE EUROPÉEN COMMUN DE RÉFÉRENCE POUR LES LANGUES», Évelyne Rosen, CLE International, 2007-
24. «LE ROBERT METHODIQUE», sous la direction de Josette Rey-Debove, Dict. Le Robert, Paris, 1989
25. «LE RONCHON», journal La Nation, Rubrique: Le Coin du Ronchon, signé sous le pseudonyme : p.2, 27 février 2009
26. «LES BELLES FIDÈLES», Etienne Barilier, CTL-UNIL, Lausanne, 1990
27. «LES FONDEMENTS SOCIOLINGUISTIQUES DE LA TRADUCTION», Maurice Pergnier, Atelier de reproduction des thèses Université de Lille III, Lille, 1978
28. «LES PROBLÈMES THÉORIQUES DE LA TRADUCTION», Georges Mounin, Gallimard, Paris, 1963
29. «LES TRADUCTEURS DANS L'HISTOIRE», Jean Delisle et Judith Woodsworth, PUO & Editions Unesco, Ottawa, 1995
30. «MBI PËRKTHIMIN ME PËRKTHYESIN*», (*SUR LA TRADUCTION AVEC LE TRADUCTEUR) Vedat Kokona, Editions Kokona, Tirana, 2003
31. «MISIONI I PËRKTHYESIT NË KULTURËN TONË POSTKOMUNISTE*» (*LA MISSION DU TRADUCTEUR DANS NOTRE CULTURE POST-COMMUNISTE), Ledi Shamku-Shkreli, 28/12/2009
32. «NJË KAMBANË PËR PËRKTHIMIN LETRAR*» (*UNE CLOCHE POUR LA TRADUCTION LITTÉRAIRE), Mira Meksi, journal Express, 10 janvier 2010
33. «PARCOURS DE TRADUCTION», Jeanne Dancette, PUL, Lille, 1995

34. «PËRKTHIMI – DETYRIM APO ZGJEDHJE*» (*LA TRADUCTION – OBLIGATION OU CHOIX), Sazana Çapriqi, journal Zëri, Prishtina, 13 juin 2010
35. «PLURILINGUISME – UN GESTE POLITIQUE FORT POUR LES LATINS», Michel Guillaume, L'Hebdo, p.21, 19 août 2010
36. «POUR UNE TYPOLOGIE DE LA TRADUCTIBILITÉ», Guy Jucquois, CTL-UNIL, Lausanne, 1991
37. «PROTRANSLATORE», Edmond Tupja, Ombra GVG, Tirana, 2004
38. «ROUGE BRÉSIL», Jean-Christophe Rufin, Editions Gallimard, Paris, NRF, 2001
39. «SÉRIES TÉLÉ: TRADUITES ET SURTOUT CENSURÉES», Geneviève Comby, journal Le Matin, pp78-79, 18 mars 2007
40. «SHKRIMTARI QË PËRKTHEU JETËN E VET*», (*L'ECRIVAIN QUI TRADUISIT SA VIE), Vullnet Krasniqi, article paru dans le journal « Koha Ditore », Prishtinë, 15 juin 2010
41. «SIGMOND FREUD APPARTIENT À TOUT LE MONDE», Michel Audétat, journal « L'Hebdo », Lausanne, p. 73, 28 janvier 2010
42. «THÉORIE DU LANGAGE ET THÉORIE DE LA TRADUCTION», Colette Laplace, Didier érudition, Paris, 1994
43. «TRADUCTION ET CULTURE», Jean-Louis Cordonnier, Hatier&Didier, Paris, 1995
44. «TRADUCTION HUMAINE ET TRADUCTION MECANIQUE», Alexandre Ljudskanov, Dunod, Paris, 1969
45. «TRADUIRE LA POÉSIE», Monique Laederach, CTL-UNIL, Lausanne, 1992
46. «TRADUIRE LE THÉÂTRE», Séminaires de CTL-UNIL, édité par Brigitte Burger, Lausanne, 1993
47. «TRADUIRE OU L'ART D'INTERPRÉTER», Jean-Claude Gémard, Presses de l'Université de Québec, Montréal, 1995
48. «TRADUIRE SANS TRAHIR», Jean-Claude Margot, L'Age d'Homme, Lausanne, 1979
49. «TRADUIRE: DÉFENSE ET ILLUSTRATION DU MULTILINGUISME», François Ost, Fayard, Paris, 2009
50. «TREGIME TË SHEKULLIT TË NJËZETË*»(*RÉCITS DU 20ÈME SIÈCLE), Sh.B. Naim Rafshëri, 10.000 ex, Tiranë, 1977

info@iseal.com
www.iseal.ch